

ELEFThERIA MANDA
ÇAMËT MYSLIMANË TË EPIRIT
(1923 – 2000)

BOTIMET TOENA

ELEFThERIA MANDA

**ÇAMËT MYSLIMANË
TË EPIRIT
(1923 – 2000)**

BOTIMET TOENA
Tiranë, 2015

Titulli i originalit: ΕΛΕΥΘΕΡΙΑ ΜΑΝΤΑ, ΟΙ ΜΟΥΣΟΥΛΜΑΝΟΙ
ΤΣΑΜΗΔΕΣ ΤΗΣ ΗΠΕΙΡΟΥ (1923-1930)

Botuese: Irena Toçi

Përktheu nga origjinali greqisht: Instituti i Studimeve Ballkanike, Selanik

Kryeredaktore: Sonila Kapo

Përkujdesja grafike: Elida Stafa

Kopertina: Albana Kuraj

ISBN 978-9928-4277-1-7

© 2004 By the Institute for Balkan Studies - Thessaloniki
All rights reserved

© 2015 Botimet Toena

Të gjitha të drejtat janë të rezervuara. Nuk lejohet shumëfishimi i materialeve që përmban ky libër me asnjë mjet apo formë, as me fotokopje, as pjesërisht, pa lejen me shkrim të Botimeve Toena.

BOTIMET TOENA

Rr. "M. Gjollësja", K. Postare 1420, Tiranë

Tel.: + 355 4 22 40 116; 22 58 893

Fax: +355 4 22 40 117

E-mail: redaksia@toena.com.al

botimet.toena@gmail.com

[Http://www.toena.com.al](http://www.toena.com.al)

PËRMBAJTJA

PARATHËNIE PËR BOTIMIN NË SHQIP	7
PROLOG.....	9
SHKURTIME	15
HYRJE	
VËSHTRIM MBI GJENDJEN E POPULLSISË ÇAME.....	17
KAPITULLI I PARË	
ÇAMËT DHE SHTETI GREK NË PERIUdhËN MES DY LUFTËRAVE	
1. Procedura e shkëmbimit të popullsive	25
2. Integrimi i çamëve në shtetin grek.....	43
5. Zhvillimi i propagandës irredentiste në Epir	108
KAPITULLI I DYTË	
SHANSI QË U KRIJUA ME SHPËRTHIMIN E LUFTËS	
SË DYTË BOTËRORE DHE KALIMI NË VEPRIMTARI AKTIVE	
1. Sulmi italian i tetorit 1940	133
2. Vitet e pushtimit italian.....	136
4. Refugjatët çamë në shtetin shqiptar gjatë viteve të para të pasluftës.	198
KAPITULLI I TRETË	
RISHFAQJA E ÇËSHTJES PAS PERIUdhËS SË LUFTËS SË FTOHTË	
1. Zhvillimet politike në dhjetëvjeçarin 1990	235
2. Organizatat patriotike të Çamëve dhe diaspora shqiptare	250

ANEKS	263
BIBLIOGRAFI	321
INDEX	327
SUMMARY	337
FOTO	345

PARATHËNIE PËR BOTIMIN NË SHQIP

Mbi dhjetë vjet kanë kaluar nga botimi i parë në gjuhën greke i librit që kini në duar, vite të pasura në zhvillime për sa u përket marrëdhënieve greko-shqiptare, dhe veçanërisht frytdhënëse për afrimin midis dy popujve.

Në këtë periudhë, dy palët kanë bërë përpjekje serioze për një qasje të re, shkencore, të çliruar nga stereotipat dhe ngërçet e së kaluarës, për shumë çështje që karakterizuan rrugëtimin historik të Grekëve dhe të Shqiptarëve në epokën moderne, midis të cilave edhe atë të Çamëve që jetuan në Epirin grek deri në fund të Luftës së Dytë Botërore. Nëpërmjet punimeve të historianëve në nivel ndërkombëtar, janë bërë të njohura më shumë ngjarje, ekzistojnë mundësi më të mëdha për një qasje tërësore dhe për një kuptim më të plotë të zhvillimeve që shënjuan vendimet dhe zgjedhjet që bënë njerëzit, të cilët ose ishin protagonistë, ose thjesht i përjetuan ato ngjarje.

Nga ky këndvështrim, botimi i parë në gjuhën greke i librit, ia arriti plotësisht qëllimit të tij, të shërbejë domethënë, si pikënisje për një dialog të mbështetur në prova e dokumente, rreth një teme të rëndësishme historike e cila është injoruar për shumë dhjetëvjeçarë.

Përkthimi i tij në gjuhën shqipe do të krijojë mundësinë që të bëhen të njohura edhe për publikun shqiptar, ato konkluzione që rezultuan nga kërkimi shkencor. Fakti se historiografia e mëvonshme shtoi edhe shumë informacione të tjera dhe plotësoi shumë prej boshllëqeve në kujtesën e bashkëkohësve, nuk besoj se ul sadopak rëndësinë e këtij libri. Prandaj do të dëshiroja të falënderoja ngrohtësisht Shtëpinë Botuese TOENA për nismën e saj, e cila krijon mundësi të reja për zhvillimin e diskutimit shkencor.

PROLOG

Prezenca historike dhe gjendja e komunitetit me prejardhje shqiptare të çamëve në Epirin e gjysmës së parë të shekullit të 20-të, mbeten deri më sot një prej temave më pak të njohura të së shkuarës relativisht të vonë të Greqisë, një temë e cila për mjaft dekada, qëllimisht ose jo, u mbulua prej heshtjes dhe u injorua prej historiografisë greke. Me të vërtetë, ky është konstatimi i parë dhe më mbresëlënës në të cilin konkludon studiuesi i asaj periudhe të trazuar të historisë moderne greke: nuk mund të thuhet se mungon krejtësisht bibliografia përkatëse, por sidoqoftë është absolutisht e pamjaftueshme dhe e papërshtatshme që të pasqyrojë në tërësinë e vet dhe të hedhë dritë në të gjitha aspektet e kësaj çështjeje të ndërlikuar dhe shumëdimensionale. Në pjesën e saj më të madhe kjo bibliografi mjaftohet me pasqyrimin e ngjarjeve që u zhvilluan gjatë periudhës së pushtimit të huaj, 1940 – 1944, një periudhë që u stigmatizua nga kulmimi dramatik i pasioneve dhe tensioneve të mëparshme, dhe injoron dhjetëvjeçarët që kishin paraprirë dhe që në një masë të madhe kishin paracaktuar rrjedhën e ngjarjeve.

Veprat e hershme të viteve të para të pasluftës civile, të cilat u përpoqën të paraqesin dhe të përshkruajnë çështjen e çamëve, duke qenë se u shkruan në afërsi kohore me ngjarjet, me nuanca politike dhe ideologjike, të destinuara për t'u shërbyer qëllimeve të tjera dhe jo rehabilitimit të realitetit, në përgjithësi njëdimensionale dhe të përzgjedhura për sa u përket atyre elementeve të kujtesës historike që duhen ruajtur, nuk mund t'u përgjigjen kërkesave të shkencës historike moderne. Për më tepër, pjesa më e madhe e këtyre veprave, të shkruara ose prej protagonistëve të ngjarjeve, ose prej intelektualëve të atij rajoni, nuk arrijnë t'u shmangen stereotipeve të vjetra të paraqitjes të së kaluarës “prej periudhës së lashtësisë deri në ditët e sotme”. Përpyekjet më të vonshme, të pakta në të vërtetë, të cilat tentuan për një qasje më serioze të çështjes, janë të kufizuara si për sa i përket

tematikës ashtu edhe kronologjisë, prandaj dhe e kanë të vështirë të na japin një pamje të plotë të zhvillimit të këtij problemi dhe të formave të ndryshme në të cilat u shfaq gjatë gjithë periudhës midis dy Luftërave Botërore, deri në përfundimin e tij të plotë njëkohësisht me mbarimin e Luftës së Dytë Botërore. Studimi që keni ndër duar, pretendon t’i japë një përgjigje boshllëkut ekzistues historiografik dhe nevojës për një qasje sa më objektive dhe të qartë të kësaj çështjeje. Për më tepër, koha dhe kushtet tashmë janë pjekur, dhe lejojnë që të nxirret nga harresa kjo pjesë e së kaluarës së humbur historike dhe t’i kushtohet vëmendja që i takon nga ana e shkencës historike moderne greke.

Si pikënisje për hulumtimin në thellësi të ecurisë historike të çamëve në Epir, shërbyen studimet e mia të karakterit më të përgjithshëm, në kuadrin e veprimtarisë sime hulumtuese dhe profesionale, mbi ecurinë e marrëdhënieve greko-shqiptare gjatë gjithë shekullit të 20-të, studime të cilat shumë shpesh e ndesha këtë çështje të diskutueshme, e cila duhet pranuar se zgjon interesin e studiuesit. Një sfidë tjetër për mua ishte konstatimi se të paktën gjatë dhjetëvjeçarit të fundit, prodhimtaria bibliografike respektive nga ana tjetër e kufirit ishte sensacionale, të paktën nga ana sasiore dhe jo domosdoshmërisht nga ana cilësore. Shtrembërimin të paramenduar të ngjarjeve historike, kuadrin të njëanshëm dhe të deformuar që paraqet pala tjetër, historiografia greke i përgjigjet me një boshllëk të pajustificuar. Por përveç këtyre, mundësinë objektive që interesimi personal dhe sfida prej së jashtmi të shndërroheshin në vepër, na e dha periudha prej pesëdhjetë e më tepër vitesh që kishin kaluar nga ngjarjet e Luftës së Dytë Botërore dhe të viteve të para të pasluftës, gjë që më lejoi që të kërkoj dhe të mbledh materiale origjinale që i takonin periudhës konkrete, të cilat ruhen në arkivat shtetërore greke, veçanërisht në Arkivin Historik të Ministrisë së Jashtme Greke, diçka që në periudhat e mëparshme ishte e paarritshme. Kjo ishte dhe pjesa e fundit që plotësoi kuadrin, të cilin unë kisha krijuar nga studimi i burimeve të tjera, si të atyre që ishin botuar ashtu edhe të atyre të pabotuara.

Pikënisje kohore për këtë studim përbën viti 1923, vit gjatë të cilit, për shkak të çështjes së madhe të shkëmbimit të popullsisë, shteti grek “zbuloi” shqiptarët çamë në Epir dhe nga rrethanat u detyrua të përvijojë për herë

të parë një politikë konkrete dhe sistematike kundrejt tyre. Diçka e tillë nuk ishte bërë në periudhën e mëparshme, megjithëse i gjithë ai rajon ishte bashkuar me shtetin grek që në vitin 1913, kryesisht për shkak të luftërave të njëpasnjëshme në të cilat u përfshi Greqia, të cilat, siç ishte e natyrshme, monopolizuan interesin e saj deri në fillimet e dhjetëvjeçarit pasardhës. Studimi i politikës shtetërore gjatë periudhës që pasoi vitin 1923, përbën në esencë objektin e kërkimeve dhe boshtin qendror, i cili përcaktoi në një masë të madhe edhe strukturën përfundimtare të këtij botimi. Një vend qendror në studim zënë kushtet në të cilët shqiptarët çamë u inkuadruan përfundimisht në shtetin grek, kushtet e jetesës dhe problemet që lindën gjatë periudhës midis dy Luftërave dhe sigurisht, kulmimi dramatik i kësaj çështjeje që ndodhi njëkohësisht me luftën italo-greke dhe pushtimin e Greqisë prej nazistëve. Mbi këtë ndërthurje të përgjithshme, vendosen dhe çështje të veçanta të cilat ishin përcaktuese për ecurinë e gjërave dhe që paraqiten dhe analizohen gjatë faqeve në vazhdim. Duke i parë në tërësinë e tyre, ato kompozojnë kuadrin e një procedure të dështuar të inkuadrimit të Çamëve në strukturat shtetërore dhe në shoqërinë greke, të trajtimit të tyre si një “trup i huaj”, të mungesës së pranimit të tyre – me përjashtime të pakta – nga ana e pushtetit qendror dhe subjekteve të tij. Ngjarjet që shënjuan Luftën e Dytë Botërore ishin rezultat i pashmangshëm i zhvillimeve pararendëse gjatë dhjetëvjeçarëve të mëparshëm dhe çuan në ikjen e tyre përfundimtare nga territori i shtetit grek.

Karakteri historik i këtij studimi është së pari i dukshëm dhe në mënyrë të padiskutueshme mbizotërues. Për këtë arsye, kapitulli i fundit i cili i referohet zhvillimeve bashkëkohore, duhet të konsiderohet thjesht si një material informues. Qëllimisht ky kapitull u përzgjedh që të jetë mundësisht sa më i shkurtër por me përmbajtje, pa referenca të veçanta për ngjarje të veçuara, për persona, data etj. Ajo që kërkohet, është që lexuesi, thjesht të plotësojë idenë që krijoi rreth një çështjeje e cila, ndërsa në teori kishte përfunduar me mbarimin e Luftës, në realitet u rishfaq në skenë, duke dalë nga harresa e pesëdhjetë e më shumë viteve, sigurisht edhe për shkak të riformatimeve dhe përmbysjeve që ndodhën ndërkohë në Gadishullin Ballkanik. Por ndërkohë që kjo çështje, me formën e saj të re ka fituar

më tepër natyrë ekonomike dhe ligjore, studimi i saj në thellësi del jashtë kuadrit të këtij libri.

Libri që keni në duar, është rezultat i një përpjekjeje kërkimore shumëvjeçare që u shtri në Greqi edhe jashtë saj, fryt i së cilës ishte grumbullimi i një materiali voluminoz arkivor, tek i cili u mbështet kryesisht rikompozimi i së shkuarës historike. Duhet të theksojmë këtu se pjesa më e madhe e këtij materiali është e pabotuar dhe për herë të parë do t'i bëhet e ditur publikut grek. Puna kërkimore përfundoi tani së fundmi, sigurisht jo pa vonesa të paparashikuara dhe probleme. Shumicën e këtyre problemeve e ndesha në vetë Shqipërinë, ku ishte e pamundur të më lejonin të kisha akses në arkivat zyrtare. Për fat të mirë, botimi për herë të parë për realitetin shqiptar i materialeve origjinale të arkivave shtetërore për periudhën midis dy Luftërave, i dha një zgjidhje të pjesshme problemit. Grumbullimi i fakteve dhe deponimeve nga burime të shumëllojshme, qasja krahasuese dhe verifikimi i informacioneve që shpesh ishin kontradiktorë mes tyre, besoj se më lejuan më së fundi që të jap një pamje sa më objektive të mundshme, të qartë dhe të plotë mbi zhvillimin e ngjarjeve, të rivendos marrëdhënien mes shkakut dhe pasojës dhe të interpretoj vendimet, veprimet si dhe stimujt e personave të veçantë apo dhe grupeve që përcaktuan në një masë të madhe ecurinë por edhe zgjedhjen që bëri ai komunitet shqiptar i Epirit. Gjykoj se ekzistenca e gabimeve brenda në tekst është deri në njëfarë mase e paevitueshme, por në asnjë rast nuk është e qëllimshme dhe për më tepër, e paramenduar. Shpresoj se botimi i këtij studimi, do të kontribuojë në korigjimin e tyre në të ardhmen. Ashtu siç shpresoj gjithashtu se me kalimin e kohës, materiale të reja arkivore, greke dhe të huaja, do të shohin dritën e botimit dhe me fakte të reja do të ndriçojnë anë të panjohura të kësaj çështjeje që deri tani kanë mbetur në errësirë.

Në përfundim të këtij prologu të shkurtër do të doja së pari, të falënderoj nga zemra profesorin, z. Vasilio Kondi, Kryetar i Institutit të Studimeve të Gadishullit të Ballkanit, i cili, përveç inkurajimit fillestar dhe mbështetjes së vazhdueshme gjatë gjithë asaj periudhe të gjatë kohore të mbledhjes së materialeve dhe shkrimit të këtij studimi, më ndihmoi gjithashtu duke më vënë në dispozicion një pjesë të madhe të arkivit të tij personal

me dokumente amerikane dhe britanike, të cilat rezultuan një burim i paçmueshëm informacioni dhe e lehtësuan në një masë të madhe gjithë përpjekjen që unë bëra.

Do të dëshiroja gjithashtu të falënderoja ngrohtësisht zotin Spiro Sfeta, lektor i Historisë Ballkanike në Universitetin Aristotelian të Selanikut, i cili kishte mirësinë fisnike të më jepte dokumente prej arkivave gjermane, që i dispononte si rezultat i kërkimeve të tij të mëparshme personale. Në të njëjtën mënyrë falënderoj zonjën Ksanthipi Koxajeorji - Zimari, bashkëpunëtore shkencore e Institutit të Studimeve të Gadishullit Ballkanik, e cila më rekomandoi dhe më informoi për ekzistencën e disa dokumenteve që kishin lidhje me çështjen të Shoqëria e Arkivit Historik dhe Letrar, duke bërë të mundur në këtë mënyrë, skedimin dhe studimin e tyre për librin në fjalë. Falënderoj gjithashtu ambasadorin e nderit zotin Evangjello Kofo, ekspert në Ministrinë e Jashtme të Greqisë, për dërgimin e materialeve dhe fakteve nga kopje dokumentesh të arkivit personal të zotit Aleko Papapanajotu që disponon dhe të cilat vijnë kryesisht prej “Arkivit të Partisë Komuniste Greke brenda vendit”. Më së fundi, falënderime të ngrohta i detyrohem zotit Joani Murello, asistent profesor i Historisë Moderne Greke në Universitetin Aristotelian të Selanikut dhe Drejtor i Institutit të Studimeve të Gadishullit të Ballkanit, për mbështetjen, për mirëkuptimin dhe për durimin që tregoi gjatë gjithë periudhës të hartimit të këtij studimi.

E. M.
Shtator 2003

SHKURTIME

ACS	Archivio Centrale di Stato, Romë
ASKI	Arkivi i Historisë Shoqërore Moderne, Athinë
ASMAE	Archivio Storico Ministero Affari Esteri, Romë
ATSH	Agjencia Telegrafike Shqiptare
AYE	Arkivi i Ministrisë së Jashtme, Athinë
BM	Bundesarchiv-Militararchiv, Fraiburg
JES/DIS	Shtabi i Përgjithshëm i Ushtrisë/Drejtoria e Historisë së Ushtrisë, Athinë.
DDI	Documenti Diplomatici Italiani
ELIA	Shoqata e Arkivit Letrar dhe Historik, Athinë
NADS	National Archives, Department of State, Uashington
PRO/FO	Public Record Office/Foreign Office, Londër
PRO/WO	Public Record Office/War Office, Londër
QIK	Qendra për Informim e Kosovës.

HYRJE

VËSHTRIM MBI GJENDJEN E POPULLSISË ÇAME

Një prej problemeve të para me të cilat ndeshet studiuesi në lidhje me prezencën e shqiptarëve çamë në Epir, është përcaktimi i madhësisë numerike të kësaj popullsie, të paktën në gjysmën e parë të shekullit të 20-të. Të dhëna zyrtare në lidhje me këtë çështje disponojmë vetëm që prej vitit 1928, kur në shtetin grek u zhvillua regjistrimi i përgjithshëm i popullsisë, i pari pas rikompozimeve dramatike për sa i përket popullsisë, të cilat i shkaktuan përplasjet e njëpasnjëshme luftarake në rajonin e Ballkanit, dhe natyrisht regjistrimi i parë pas ardhjes dhe vendosjes në territorin e shtetit grek, të refugjatëve nga Azia e Vogël, që siç dihet, përmbysën strukturën etnologjike të deriatëhershme të popullsisë së vendit.

Për periudhën para vitit 1928, nga të dhënat e pakta të besueshme që disponojmë, mund të përmendim edhe ato që na vijnë prej Komisionit Miks të Shkëmbimit të Popullsive, anëtarët e të cilit realizuan një turne në të gjithë Epirin në Qershor të vitit 1925¹. Pra, sipas këtyre të dhënave, popullsia myslimane e Epirit ishte atëherë 20.160 banorë, të cilët jetonin të shpërndarë në 63 qytete dhe fshatra. Deri në atë datë, Nënkomisioni i 14-të kompetent i Epirit, të cilit i ishte ngarkuar detyra e shkëmbimit të popullsive, kishte shpallur si të shkëmbyeshëm, pra persona që duhej të shkëmbeheshin, gjithsej 2.993 myslimanë, të cilët ishin larguar nga Greqia dhe ishin nisur për në Turqi. Këto janë edhe të dhënat e para që kemi në dispozicion për sa u përket shqiptarëve myslimanë të Epirit, të dhëna që siç rezulton edhe nga shifrat në vazhdim, duket se janë mjaft afër së vërtetës.

¹ Më shumë për Komisionin, shih më poshtë, fq. 28 dhe në vazhdim.

Sipas rezultateve të regjistrimit të popullsisë që u zhvillua më 15 – 16 Maj 1928², në Epir, në një total popullsie prej 312.634 banorësh, ekzistonin 17.008 myslimanë që flisnin gjuhën shqipe, të cilët pa rezerva duhet të identifikohen si çamë. Ndërkohë vihen re disa mospërputhje të vogla për sa i përket regjistrimit të popullsisë veças, sipas fesë dhe sipas gjuhës. Në këtë mënyrë, në tabelën e rezultateve sipas fesë, myslimanët e Epirit rezultojnë të jenë 19.244 persona, por vetëm 17.029 deklarojnë si gjuhë të tyre amtare, gjuhën shqipe. Me shumë gjasa, devijimi i vogël nga numri 17.008 që gjendet në tabelën përmbledhëse të regjistrimit të popullsisë sipas fesë dhe sipas gjuhës, ka lidhje me faktin, se disa qytetarë deklaruan si gjuhë amtare gjuhën shqipe, por si gjuhë të folur gjuhën greke, diferencim ky që do ta ndeshim edhe më vonë, gjatë regjistrimit të popullsisë të vitit 1940. Sidoqoftë, kjo popullsi gjendej e përqendruar kryesisht në nënprefekturat e Thiamidhos (Filatit) dhe Paramithisë, të cilat në atë periudhë i përkisnin prefekturës së Janinës, si dhe në nënprefekturën e Margaritit, të prefekturës së Prevezës. Në mënyrë më analitike, 57 myslimanë që flisnin gjuhën shqipe u regjistruan në prefekturën e Artës, 12.194 në prefekturën e Janinës (nënprefektura e Janinës 637, nënprefektura e Konicës 87, nënprefektura e Paramithisë 1.367, nënprefektura e Pogonit 247 dhe nënprefektura e Thiamidhos 9.856) dhe 4.757 në prefekturën e Prevezës (nënprefektura e Margaritit 4586, nënprefektura e Prevezës 139 dhe nënprefektura e Filipiadhës 32). Nga të dhënat e regjistrimit të popullsisë rezultoi gjithashtu se në atë periudhë në rajonin e Epirit gjendeshin 1.246 nënshtetas shqiptarë (21 në prefekturën e Artës, 1.096 në prefekturën e Janinës dhe 129 në prefekturën e Prevezës).

Duke kombinuar ndërkohë informacione që disponojmë prej burimeve të tjera dhe që i takojnë së njëjtës periudhë, mundemi të vlerësojmë me një siguri relative, se numri prej pothuajse 17.000 myslimanësh që flisnin gjuhën shqipe, siç na rezultoi prej regjistrimit, është paksa i zvogëluar. Kjo sigurisht që nuk shkakton ndonjë përshtypje të veçantë, nëse marrim parasysh rrethanat nën të cilat u realizua regjistrimi i popullsisë në vitin 1928, periudhë gjatë së

² Shërbimi i Përgjithshëm Statistikor i Greqisë, *Rezultate Statistike të regjistrimit të popullsisë së Greqisë, dt. 15-16 Maj 1928. Vëllimi I. Popullsi reale dhe e ligjshme - Refugjatë*, Athinë 1933, *Vëllimi IV. Vendlindja-Feja dhe Gjuha-Shtetësia*, Athinë 1935.

cilës shteti grek, i sapodalë nga peripeci të njëpasnjëshme dhe veçanërisht të dhimbshme luftarake, interesohet që në mënyrë të menjëhershme të rigrumbullojë dhe të masë forcat e veta si dhe të manifestojë homogjenitetin e vet etnik. Atmosfera që mbizotëronte, sigurisht që nuk favorizonte deklarin e lirë dhe pa pengesa si dhe regjistrimin e dallueshmërisë, dhe një prej viktimave ishin popullsitë e një kombësie ose një gjuhe tjetër që kishin mbetur brenda territorit të shtetit grek. Është e sigurt se shumë prej banorëve *bilingue* të Epirit hezitonin të deklaronin një gjuhë tjetër përveç gjuhës greke. Kjo ishte dobësia kryesore e regjistrimit të grupeve linguistike prej përfaqësuesve të shtetit, kur dihet se shteti nuk favorizon gjuhë tjetër përveç gjuhës zyrtare kombëtare³. Në këtë mënyrë, na duhet të konsiderojmë se janë më afër realitetit të dhënat që grumbullojmë nga raporte dhe regjistrime për efekt pune dhe shërbimesh të ndryshme të autoriteteve vendore të kohës dhe që u drejtohen institucioneve qendrore⁴, të cilave u ishte ngarkuar detyra e grumbullimit të të dhënave që kishin lidhje jo vetëm me numrin e shqiptarëve myslimanë të Epirit, por edhe me vendet ku ishin vendosur, pozitën e tyre sociale dhe ekonomike, shkallën e integritit të tyre në shoqërinë lokale dhe deklarin e ndërgjegjes së tyre kombëtare. Pra, sipas atyre që përmendëm më lartë, numri i myslimanëve shqiptarë që jetonin në nënprefekturat e Paramithisë, të Margaritit dhe të Thiamidhos, ishte 19.618 persona. Më konkretisht, 2.644 persona banonin në nënprefekturën e Paramithisë, 5.594 persona banonin në nënprefekturën e Margaritit dhe 11.380 persona banonin në nënprefekturën e Thiamidhos, të shpërndarë në 31 komunitete të mirëfillta myslimane dhe në 21 komunitete të përziera gjithsej. Është e kuptueshme se te ky numër nuk përfshihen shqiptarët e paktë myslimanë në numër të nënprefekturave dhe të qendrave të tjera urbane të Epirit të cilët ndërkohë figurojnë në regjistrimin zyrtar të popullsisë.

Që nga ajo periudhë e në vazhdim, të dhënat që herë pas here jepen prej burimeve greke për të gjithë dhjetëvjeçarin e 1930-ës, nuk kanë ndonjë ndryshim të madh prej këtyre të dhënave të para. Kështu, në vitin 1932,

³ Shih edhe Io. Koliopoulou, *Grabitje pikëpamjesh. Çështja Maqedonase në Maqedoninë Perëndimore të pushtuar 1941-1944*, Selanik 1994, fq. 39.

⁴ AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 6527, Nën-Administrata e Paramithisë dhe Margaritit drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Paramithi 25-5-1928.

Administrata e Përgjithshme e Epirit, duke grumbulluar të dhëna prej kryetarëve të komunave respektive, llogarit një shifër për myslimanët shqiptarë prej 19.135 personash (2.332 në nënprefekturën e Paramithisë, 11.427 në nënprefekturën e Thiamidhos dhe 5.376 në nënprefekturën e Margaritit)⁵, ndërsa po atë vit, edhe nënprefekti i Thiamidhos flet për 19.437 myslimanë që banojnë në 55 fshatra gjithsej⁶, myslimane dhe të përziera. Gjithsesi, është me rëndësi të theksohet fakti se devijime të konsiderueshme nga këto shifra, nuk paraqesin as vlerësimet më të besueshme dhe më të qarta të vetë shqiptarëve në atë periudhë. Në fillim të vitit 1928, Fejzi Lepenica, një refugjat politik shqiptar që jetonte prej vitesh në Janinë, në një raport të tij të zgjeruar, ku paraqiten me hollësi kushtet e jetesës së bashkëkombësve të tij në Epir dhe problemet me të cilat ata përballen brenda shtetit grek⁷, thekson se numri i tyre në atë periudhë arrinte në 23–24.000 persona. Në vitin 1913, kur Epiri u bashkua me Greqinë, numri i shqiptarëve, gjithmonë sipas Lepenicës, ishte diku te 40.000 vetë, por shumë prej tyre u detyruan të braktisin rajonin dhe të largohen ose drejt Turqisë ose drejt Egjiptit, si për shkak të masave shtrenguese që zbatonin kundër tyre autoritetet greke, ashtu edhe për shkak të indiferencës që tregoi kundrejt tyre në atë periudhë qeveria shqiptare.

Në vitin 1936, për arsye që do t'i trajtojmë në mënyrë më analitike në vazhdim, në Epir u realizua një reformë administrative e përmasave të gjera, në zbatim të së cilës nënprefekturat e Thiamidhos (Filatit), Paramithisë dhe Margaritit u bënë pjesë përbërëse e prefekturës së sapokrijuar të Thesprotisë. Numri i myslimanëve çamë, tashmë banorë të kësaj prefekturë, sipas vlerësimeve greke, ishte në atë periudhë 17.311 persona⁸. Ndërkohë duhet

⁵ AYE, 1935, A/21/I, nr. pr. 3224, Administrata e Përgjithshme e Epirit drejtuar Ministrisë së Jashtme, Janinë 3-3-32.

⁶ AYE, 1935, A/4/9, nr. pr. 55, Nënprefekti i Thiamidhos për Zyrën Politike të Kryeministrit, Sektori i Minoriteteve, Filat 16-4-1932.

⁷ Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Dokumente për Çamërinë 1912-1939, Tiranë 1999, nr. 294, fq. 555-560. Lepenica rezulton jo vetëm njohës i mirë i realitetit në Epir, por duke mos pasur asnjë post qeveritar apo funksion tjetër, nuk ka arsye që të fryjë numrin e banorëve Shqiptarë në atë rajon.

⁸ AYE, 1937, A/4/9, nr. pr. 736, Administrata e Përgjithshme e Epirit drejtuar Ministrisë së Punëve të Jashtme, Janinë 24-10-1936.

të supozojmë me një siguri relative, se ky numër nuk na tregon realitetin dhe se në ato vite, duke e konsideruar si të padiskutueshëm edhe shtimin natyral të popullsisë, shqiptarët në Epir duhet ta kishin kaluar numrin e 20.000 banorëve. Kështu që më afër realitetit janë tabelat që i dërgon po atë vit Tiranës konsulli shqiptar në Janinë⁹, tabela që u përpiluan pikërisht për shkak të krijimit të kësaj prefekturë të re. Pra sipas të dhënave konsullore shqiptare, shqiptarët myslimanë të Thesprotisë ishin 23.048 persona: Nga këta, 8.285 në nënprefekturën e Igumenicës, 7.270 në nënprefekturën e Margaritit, 5.410 në nënprefekturën e Filatit dhe 2.083 në nënprefekturën e Paramithisë.

Po ashtu besojmë se i zvogëluar është edhe numri i shqiptarëve myslimanë që na japin të dhënat e regjistrimit të popullsisë që u zhvillua më 16 Tetor 1940, për të cilat duhet të theksojmë se nuk janë analitike¹⁰. Pra sipas këtyre të dhënave, në të gjithë territorin e shtetit grek banonin 16.890 myslimanë që deklaruan si gjuhë të tyre amtare gjuhën shqipe, ose, sipas një vlerësimi të dytë, 15.015 myslimanë që zakonisht flisnin gjuhën shqipe në jetën e tyre të përditshme. Por me qëllim që të nxjerrim një konkluzion të saktë, duhet të marrim patjetër parasysh kushtet nën të cilat u realizua regjistrimi i popullsisë në vitin 1940: prej muajsh në vend mbretëronte atmosfera e luftës dhe me gjithë përpjekjet e Qeverisë Metaksa që t'i qëndronte larg dhe të mos jepte shkas, sulmi italian tashmë ishte te pragu. Nga ana tjetër, siç do t'i referohemi në mënyrë më specifike në vazhdim, madje që në Qershor të po atij viti dhe deri në prag të shpërthimit të luftës, shumë çamë, me nxitjen e propagandës shqiptare dhe italiane, kishin kaluar në mënyrë ilegale kufirin me qëllim që të formonin grupe të armatosura të cilat, në vazhdim, do të inkuadroheshin në radhët e ushtrisë italiane. Vlerësimet e asaj periudhe flasin për një numër prej 2.000 – 3.000 çamësh që kaluan në Shqipëri, megjithëse ne besojmë se, në kushtet nën të cilat u realizua ky kalim ilegal drejt shtetit shqiptar, asnjë shifër nuk mund të konsiderohet si e saktë. Së fundmi, nuk duhet që t'i shpëtojë vëmendjes

⁹ Dokumente për Çamërinë, nr. 359, fq. 682-685.

¹⁰ Shërbimi i Përgjithshëm Statistikor i Greqisë, *Popullsia e Greqisë gjatë regjistrimit të 16 Tetorit 1940*, Athinë 1950 dhe *Rezultatet e regjistrimit të popullsisë të 7 Prillit 1951*, Athinë 1961.

sonë më i rëndësishmi prej faktorëve të shumtë që ndikuan në rezultatet e regjistrimit të popullsisë dhe ky faktor është sigurisht gjendja e brendshme që mbizotëronte në vend në atë periudhë dhe në veçanti shtrëngesat nën të cilat ishin vendosur popullsitë e një kombësie tjetër ose të një gjuhe tjetër që ndodheshin në territorin e shtetit grek, nën “kujdesin” e zëvendësministrit të Sigurisë Publike, Konstantinos Maniadhakis. Edhe pse krahasimisht me grupet e tjera, për shembull me sllavishtfolësit e Maqedonisë, çamët e Epirit e ndjenin më pak shtrëngimin e darës së shtetit policor, në asnjë rast nuk mund të pranojmë se kishin mundësi të deklaronin lirisht prejardhjen etnike dhe gjuhën e tyre gjatë procedurës së regjistrimit të popullsisë.

Kështu që, nëse dëshirojmë të kemi një përfytyrim të gjendjes së popullsisë së myslimanëve shqiptarë të Epirit, që t’i afrohet në mënyrën më të mirë të mundshme realitetit, na duhet t’u rikthehemi shifrave që i takojnë mesit të dhjetëvjeçarit të 1930-ës dhe të përcaktojmë numrin e tyre përafërsisht 23.000 - 24.000, ashtu siç e citojnë edhe vetë shqiptarët. Në favor të vërtetësisë së këtyre të dhënave, flasin edhe vlerësimet e mëvonshme që na vijnë nga periudha e luftës, kur edhe Britanikët, në bazë të të dhënave që grumbulluan në terren, vlerësojnë se numri i popullsisë shqiptare të Epirit është afërsisht 25.000 vetë¹¹. Por për këtë periudhë do të flasim në mënyrë më analitike në vazhdim.

Për t’i dhënë trajtë më të plotë pamjes mbi ndryshimet sasiore të shqiptarëve në Epir, na duhet të shtojmë edhe rezultatet e regjistrimit të popullsisë që u zhvillua më 7 Prill 1951, i cili na jep të dhëna më analitike, krahasimisht me regjistrimin e vitit 1940 mbi çështjen që po trajtojmë¹²:

a) 22.736 nënshtetas grekë në të gjithë territorin e Greqisë deklaruan gjuhën shqipe si gjuhë amtare, nga të cilët 7.357 në Epir. Nga këta, 7.230 janë ortodoksë dhe vetëm 127 myslimanë, të cilët duhet të identifikohen si çamë (77 në prefekturën e Thesprotisë, 47 në prefekturën e Janinës dhe 3 në prefekturën e Prevezës).

¹¹ Shih si tregues PRO/FO, 371/48094, Report by LT Col C.A.S. Palmer on visit to Northern Greece, 9-14 April 1945 tek Aneksi, nr. 10, fq. 304.

¹² Shërbimi i Përgjithshëm Statistikor i Greqisë, Rezultatet e regjistrimit të popullsisë më 7 Prill 1951.

b) Sipas një vlerësimi të dytë, 7.803 nënshtetas grekë në të gjithë vendin deklaruan se zakonisht përdornin gjuhën shqipe në jetën e tyre të përditshme.

Ndryshimi midis gjuhës amtare dhe gjuhës së folur tregon se shumë prej tyre, megjithëse si gjuhë amtare kishin një gjuhë tjetër, në jetën e përditshme flisnin gjuhën greke. Nga këta 7.803 nënshtetas, 3.319 prej tyre jetonin në Epir, prej këtyre, 3.260 ishin ortodoksë dhe vetëm 59 myslimanë (57 në prefekturën e Thesprotisë, 1 në prefekturën e Janinës dhe 1 në prefekturën e Prevezës).

Diferenca e madhe që rezulton midis numrit të çamëve në vitin 1951 dhe numrit të tyre në vitin 1940, sigurisht që i dedikohet ikjes së tyre masive nga vendi pas tërheqjes së Gjermanëve në vitin 1944. Fillimisht çamët u vendosën në rajone të Shqipërisë jugore, përgjatë kufirit, por në vazhdim u zhvendosën më në veri, drejt rajoneve qendrore të vendit. Vendbanime të përhershme të tyre sot janë kryesisht rajonet e Sarandës, Delvinës, Vlorës, Beratit dhe Tiranës.

KAPITULLI I PARË

ÇAMËT DHE SHTETI GREK NË PERIUdhËN MES DY LUFTËRAVE

1. Procedura e shkëmbimit të popullsive

Rrënjët e çështjes së myslimanëve çamë të Epirit gjatë periudhës së parë pas Luftës së Parë Botërore duhet t'i kërkojmë në praktikën e shkëmbimit të popullsive, një praktikë që u ndoq sidomos në dhjetëvjeçarët e parë të shekullit të 20-të, si rezultat i ballafaqimeve luftarake dhe të rinkofigurimeve territoriale që u shënuan në hapësirat e Ballkanit Jugor. Zgjerimi i vendeve ballkanike në kurriz të zotërimeve territoriale europiane të Perandorisë Otomane e shndërroi automatikisht grupin mbizotërues të myslimanëve Osmanë në minoranca të shpërndara në territoret që sapo u ishin bashkëngjitur shteteve ballkanike. Njëkohësisht, grupe të rëndësishme etnike, linguistike apo dhe fetare, nuk ia dolën që të përfshiheshin brenda kufijve të rinj të çdo “atdheu mëmë” respektiv, një fakt ky që lehtësoi fare pak ecurinë politike brenda secilit vend si dhe marrëdhëniet ndërballkanike, dhe njëkohësisht e bëri më intensive ndjenjën e pasigurisë kombëtare te pushteti qendror. Në kuadrin e këtyre fakteve të reja, masat që u zbatuan për shkëmbimin e popullsive, u gjykuan si zgjidhja më rrënjësore dhe më e qëndrueshme e problemit që ishte shfaqur. Marrëveshja midis shtetit grek dhe atij turk mbi shkëmbimin e detyrueshëm të banorëve të krishterë ortodoksë të Turqisë me banorët myslimanë të Greqisë, e cila u nënshkrua më 30 Janar 1923 në Lozanë, përbën sigurisht shembullin më karakteristik dhe njëkohësisht më të dhimbshëm të zbatimit të këtyre masave¹.

¹ Më shumë për shkëmbimin e popullsive midis shtetit grek e atij turk, shih D. Pentzopoulos. *The Balkan Exchange of Minorities and its Impact upon Greece*, Paris 1962. Gjithashtu St. Ladas, *The Exchange of Minorities. Bulgaria, Greece and Turkey*, New York 1932.

Kjo çështje ka ndërkohë dhe një përmasë tjetër më pak të njohur, e cila ka të bëjë me popullsi të kufizuara, si për sa i përket numrit të tyre ashtu edhe shtrirjes në zonën ku banonin: bëhet fjalë për fatet e banorëve myslimanë të Epirit dhe të Maqedonisë Perëndimore, të cilët në vija të përgjithshme konsideroheshin me origjinë shqiptare. Ky fakt e bënte problematike përfshirjen e tyre tërësore që në fillim te popullsitë e tjera myslimane që i nënshtroheshin masave të shkëmbimit të detyrueshëm. Teksti përfundimtar i Marrëveshjes greko-turke mbi Shkëmbimin e popullsive nuk përmbante asnjë referencë të veçantë për këta banorë, përderisa nga shkëmbimi i popullsive parashikohej të përjashtoheshin vetëm të krishterët ortodoksë të Stambollit dhe banorët myslimanë të Thrakës Perëndimore. Ndërkohë, delegacioni grek që kishte marrë pjesë në negociatat e Lozanës, kishte deklaruar nëpërmjet përfaqësuesit të tij Dhimitrios Kakllamanos, në 19 Janar 1923, domethënë para se të nënshkruhej teksti përfundimtar i Marrëveshjes, se “Greqia nuk është aspak e predispozuar të procedojë me shkëmbimin e myslimanëve me origjinë shqiptare. Shqiptarët banojnë në një rajon rigorozisht të përcaktuar, në Epir, dhe megjithëse feja e tyre është e njëjtë me fenë e Turqve, ata janë me kombësi të ndryshme”². Më vonë Dhimitrios Kakllamanos do të deklaronte se këtë vendim për përjashtimin, qeveria greke e mori pas kërkesës së përfaqësuesit italian në negociatat e Lozanës dhe prej presioneve të ngjashme që ushtruan Fuqitë e tjera, por edhe për të treguar se e karakterizonte fryma e bashkëpunimit dhe e pajtimit dhe për të shmangur dëbimin e popullsive, të cilat, me gjithë fenë e tyre myslimane, ishin me origjinë shqiptare. Dihet se fuqitë e interesuara të asaj kohe, Anglia, Franca dhe Italia, dëshironin që t’i mbanin në një nivel të mirë marrëdhëniet e tyre me qeverinë shqiptare, pasi në atë periudhë po vazhdonin negociatat për dhënien me koncesion të të drejtave të shfrytëzimit të shtresave naftëmbajtëse në Shqipëri. Nga ana tjetër, edhe Greqia kishte nevojë që të fitonte kredibilitetin e duhur jashtë, përderisa,

² B. Kondis, “The Greek Minority in Albania”, në *Balkan Currents. Studies in the History, Culture and Society of a Divided Land*, L.A. Tritle (ed.), The Basil P. Caloyeras Center for Modern Greek Studies, Los Angeles 1998, fq. 79-93.

duke u përballur me veprën titanike të akomodimit të një milion e më shumë refugjatëve nga Azia e Vogël, kishte nevojë për mbështetje nga komuniteti ndërkombëtar, në mënyrë që të siguronte kreditë e domosdoshme për refugjatët³.

Çështja duket se kishte tërhequr që herët interesimin e qeverisë shqiptare: pak ditë para deklaratës së mësipërme të Dhimitrios Kakllamanos dhe ndërkohë që diskutimet rreth problemit të shkëmbimit të popullsisë vazhdonin akoma, i dërguari i qeverisë shqiptare në Lozanë, Mehdi Frashëri, i kishte dërguar letër kryetarit të Komisionit, përgjegjës për minoritetet, italianit Antonio Montanja, nëpërmjet së cilës dëshironte të tërhiqte vëmendjen e tij rreth çështjes së prezencës së shqiptarëve në rajonet jugore të Epirit, një komunitet, që siç pretendonte ai, nuk kishte asnjë lidhje gjuhësore, racore apo dhe kulturore me elementin turk dhe për këtë arsye ky komunitet duhej të përjashtohej nga shkëmbimi i popullsisë⁴. Në përgjigjen e tij drejtuar të dërguarit shqiptar, që u dërgua një ditë pas deklaratës së përfaqësuesit grek, kryetari i Komisionit e informonte se, si përfaqësuesi grek Kakllamanos, ashtu edhe përfaqësuesi turk Riza Nur, kishin deklaruar se banorët shqiptarë të Turqisë dhe të Greqisë do të përjashtoheshin “*de droit et de fait*” nga shkëmbimi i popullsisë. Dhe që në momentin kur këto deklarata ishin përfshirë në procesverbalet e mbledhjes, nuk gjykohej më si e domosdoshme që të kishte një referencë të posaçme në tekstin e marrëveshjes zyrtare për shkëmbimin e popullsisë në lidhje me këtë çështje⁵. Për më tepër, ashtu siç kishte theksuar edhe përfaqësuesi grek, në rast se ky përjashtim përmendej shprehimisht në nenin 1 të marrëveshjes mbi shkëmbimin e popullsisë (ashtu siç kishte propozuar fillimisht edhe përfaqësuesi italian Montanja), atëherë do të fillonte një numër pambarim kundërshtimesh dhe apelimesh dhe do të kërkohej të bëhej regjistrimi i popullsisë në bazë të kombësisë, gjë që do të kërkonte

³ Kondis, si më lart dhe L. Divani, *Greqia dhe minoritetet. Sistemi i mbrojtjes ndërkombëtare i Lidhjes së Kombeve*, Athinë 1995, fq. 223 – 224.

⁴ *Dokumente për Çamërinë*, nr. 41, fq. 86-87 dhe H. Isufi, “Politika e shtetit grek për dëbimin e popullsisë çame në vitet 1914 – 1928 dhe qëndresa shqiptare”, *Studime Historike* 1-4 (1993), 61 – 77.

⁵ *Dokumente për Çamërinë*, nr. 43, fq. 88 - 89

një kohë jashtëzakonisht të gjatë⁶. Kështu që deklaratat e dy delegacioneve u konsideruan nga të gjitha palët si obliguese për qëndrimin që pritej të mbahej në të ardhmen dhe nga ana ligjore çështja u mbyll këtu.

Por në fakt, ashtu siç u vërtetua përfundimisht, gjërat nuk ishin kaq të thjeshta sa dukeshin, së paku në fillim, sepse përcaktimi përfundimtar i prejardhjes etnike të Çamëve, rezultoi një ndërmarrje veçanërisht e vështirë. Problemi u shfaq kur Këshilli i Lidhjes së Kombeve krijoi Komisionin e posaçëm Miks për Shkëmbimin e Popullsive Greke dhe Turke, me seli në Stamboll, i cili kishte për detyrë të merrej me zbatimin e masave për shkëmbimin e popullsive⁷. Përderisa nuk ekzistonin udhëzime konkrete në lidhje me myslimanët Shqiptarë, K. M. Widding propozoi që çështja të rregullohej me kontakte të drejtpërdrejta midis qeverisë greke dhe qeverisë shqiptare. Ndërkohë, si delegacioni grek ashtu edhe delegacioni turk ishin të mendimit se qeveria shqiptare nuk kishte asnjë të drejtë që të përfshihej në këtë çështje, e cila duhej t'i takonte kompetencave ekskluzive të Komisionit Miks.

Gjatë zbatimit në praktikë në muajt e parë, të masave për shkëmbimin e popullsive në Maqedoninë Perëndimore dhe në Epir, duket se autoritetet greke ishin të vendosura të përdornin si kriter të vetëm për përjashtimin e Shqiptarëve nga shkëmbimi, certifikimin e origjinës së tyre nga Shqipëria, në bazë të vendit të lindjes të vetë personave apo dhe të të parëve të tyre⁸. Qeveria shqiptare e konsideroi të papranueshme këtë gjë dhe pretendonte se shqiptarët do ta kishin të pamundur të paraqisnin “certifikata prejardhjeje”, si rezultat, ata përfundimisht do të dërgoheshin në Turqi, së bashku me popullsitë e tjera myslimane⁹. Në mënyrë që të shmangej një zhvillim i tillë i mundshëm, pala shqiptare, gjatë gjithë muajve tetor dhe nëntor 1923, vazhdoi përpjekjet për t'u afruar me tri Fuqitë: Anglinë,

⁶ *Dokumente për Çamërinë*, nr. 45, fq. 90-92 dhe Kondis, “The Greek Minority in Albania”, fq. 79-93.

⁷ Komisioni përbëhej nga 11 anëtarë, 4 Grekë, 4 Turq dhe 3 anëtarë asnjanes, nga vende që nuk kishin marrë pjesë në luftë. Në fund, si anëtarë asnjanes u përzgjodhën E. E. Ekstrand, M. M. de Lara dhe K. M. Widding.

⁸ Ladas, *The Exchange of Minorities*, fq. 384 -385.

⁹ *Dokumente për Çamërinë*, nr. 72, fq. 117 – 118.

Francën dhe Italinë dhe për të kërkuar ndërhyrjen e tyre pranë qeverisë greke, në mënyrë që ajo të respektonte obligimet e saj të datës 19 Janar. Njëkohësisht, nëpërmjet përfaqësuesit të saj në Gjenevë, qeveria shqiptare bëri përpjekje hulumtuese pranë Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, Erik Drummond, me qëllim që të krijonte një ide të qartë mbi pikëpamjet e tij në lidhje me një apelim të mundshëm shqiptar te kjo organizatë për paraqitjen e çështjes¹⁰. Në këtë pikë ia vlen të theksohet se paraqitja e kësaj kërkesë të gjitha palët, shoqërohej me një vendim-paralajmërim të kryetarit të qeverisë shqiptare Ahmet Zogu se, në rast se Greqia nuk u përgjigjej me vepra, obligimeve të saj, Shqipëria mendonte se, për të mbrojtur interesat e bashkëkombësve, duhej të avanconte në shkëmbimin e popullsisë shqiptare të Epirit me Grekët e Shqipërisë dhe të vendoste Çamët në pronat që do të braktisnin Grekët gjatë largimit të tyre¹¹. Një zhvillim i tillë i mundshëm dhe toni paralajmërues që u përdor, shqetësuan veçanërisht Sekretarin e Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, i cili tentoi t'u priste rrugën metodave të tilla të shqiptarëve. Kështu që ai propozoi se nëse do të dështonin demarshet që mund të bënin tri Fuqitë pranë qeverisë greke, atëherë qeveria shqiptare, duke u mbështetur në nenin 11, paragrafi 2 të Kartës Statutore të Lidhjes së Kombeve, do të mund ta shtronte çështjen për diskutim në Këshill. Madje në kuadër të një apelimi të ngjashëm turk në Këshill kundër Greqisë, ai propozoi që dy çështjet të diskutoheshin njëkohësisht¹².

Disa prej fakteve që duhen nënvizuar duke pasur parasysh këtë përpjekje të Shqipërisë dhe të cilat kanë një rëndësi e cila i kapërcen konjunkturën konkrete momentale si dhe synimet e asaj periudhe, janë si më poshtë: E para, bëhet e qartë që shumë herët, që prej muajve të fundit të vitit 1923 dhe shumë kohë më përpara se të vendoseshin kushtet dhe kriteret e qarta për përjashtimin e shqiptarëve nga shkëmbimi i popullsisë, se një qeveri shqiptare – në rastin konkret ajo e Ahmet Zogut, e një beu nga rajoni i Matit në Shqipërinë e Veriut dhe më

¹⁰ *Dokumente për Çamërinë*, nr. 89-95, fq. 144-154.

¹¹ Si më lart.

¹² Si më lart, nr. 95, fq. 150-154.

vonë President dhe Mbret i vendit – propozon shkëmbimin e popullsive greke dhe shqiptare¹³, një propozim që do ta shohim se do të dalë përsëri në skenë gjatë periudhave kur marrëdhëniet mes dy vendeve ishin në krizë. E dyta, në këtë rast, çdo vëzhgues mund të dallojë shenjat e para të tendencës së shqiptarëve për të përdorur çamët myslimanë si kundërpeshë ndaj minoritetit grek të Shqipërisë si dhe të ndërlihdin reciprokisht fatet e tyre, një tendencë që do të karakterizojë praktikat e herëpashershme shqiptare kundrejt kësaj çështjeje edhe në të ardhmen, madje edhe deri në ditët tona.

Më së fundi, duke ndjekur edhe këshillën e Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve Erik Drummond, qeveria shqiptare e shtroi çështjen para Këshillit të Lidhjes së Kombeve¹⁴ dhe diskutimi përkatës u zhvillua në seancën e 17 Dhjetorit 1923¹⁵. Thelbi i mosmarrëveshjeve mes dy palëve, siç rezulton nga përmbajtja e diskutimeve, qëndronte në dy çështje: te nevoja e ngritjes së një komisioni të ri, i cili do të merrej me shqyrtimin e çështjeve që kishin lidhje me myslimanët me origjinë shqiptare si dhe te fakti nëse Komisioni Miks ishte kompetent apo jo që të trajtonte çështje që kishin lidhje me dëmshpërblimet për shpronësimet pasurore të shqiptarëve që nuk ishin objekt i shkëmbimit të popullsive¹⁶. Më së fundi, Këshilli vendosi se, Komisioni Miks që ishte ngritur për zbatimin e masave për shkëmbimin e popullsive, do të kishte

¹³ Madje, në mbledhjen e tij të datës 29 Nëntor të po atij viti, Këshilli i Ministrave të Shqipërisë vendosi që, në rast se demarshet në Lidhjen e Kombeve në favor të shqiptarëve të Greqisë nuk do të jepnin rezultat, atëherë, “autoritetet shqiptare urdhërohen të marrin masat e mësipërme respektive kundër greqishtfolësve që jetojnë në Shqipërinë e jugut”. Këto masa përfshinin regjistrim dhe bllokim të shtëpive dhe të pronave të “greqishtfolësve” dhe përgatitje për t’u vendosur në to të shqiptarëve që do të vinin nga Greqia, pasi më parë të dëboheshin Grekët. *Dokumente për Çamërinë*, nr. 99, fq. 162-163.

¹⁴ Si më lart, nr. 103, fq. 167 – 169.

¹⁵ Hollësi për diskutimin dhe qëndrimet greke dhe shqiptare shih D. Mihalopoulos, *Çamët*, Athinë 1993, fq. 33-36.

¹⁶ Siç dihet, në shkurt 1923, qeveria e Plastirës kishte marrë një sërë vendimesh që kishin të bënin me shpronësimin e detyrueshëm të pronave private dhe dhënien e sipërfaqeve publike ose që u takonin njërive vendore, për t’u vendosur refugjatët që mbërrinin nga Azia e Vogël dhe për t’u rimëkëmbur ekonomikisht bujqit pa tokë. Me po këto vendime, rregullohej edhe mënyra e dëmshpërblimit të atyre që u takonte. Për kundërshtimet e palës shqiptare për sa u përket këtyre vendimeve, shih Mihalopoulos, si më lart, fq. 33-34.

kompetenca edhe për myslimanët shqiptarë dhe tashmë i besohej këtij Komisioni grumbullimi i informacioneve të domosdoshme dhe marrja e vendimeve të nevojshme. Kështu që iu dha fund këtij diskutimi në një mënyrë që e kënaqte palën greke, e cila po shihte se po pranoheshin argumentet dhe siguritë që ajo jepte¹⁷.

Komisioni Miks, gjatë mbledhjes së tij të datës 14 Mars 1924, vendosi se myslimanët e Epirit që kishin origjinë shqiptare, do të duhej të përjashtoheshin nga shkëmbimi i popullsisë. Madje, nëse kjo gjykohej e nevojshme, do të emëronte një trupë të posaçme për grumbullimin e informacioneve lidhur me personat që do të duhej të përjashtoheshin nga shkëmbimi. Por ndërkohë, dhe deri sa të merrej një vendim përfundimtar, nënkomisionet që ishin përgjegjëse për zbatimin në vend të masave për shkëmbimin, do të duhej të anulonin përkohësisht nisjen e atyre personave që deklarorin se kishin prejardhje shqiptare¹⁸. Në zbatim të vendimit të mësipërm Komisioni Miks emëroi më në fund një përfaqësi të posaçme treanëtarëshe, së cilës iu ngarkua detyra e hulumtimit në vend të çështjes. Kryetar u emërua E. E. Ekstrand dhe anëtarë të kësaj përfaqësie u emëruan Hamdi Beu dhe P. Metaksai, të shoqëruar prej dy sekretarëve. Përfaqësia, në muajin Maj të po atij viti, vizitoi Epirin dhe Maqedoninë Perëndimore, ku qëndroi për pothuajse katër javë dhe u takua me grupe banorësh nga fshatrat e atyre rajoneve, me persona që ishin përzgjedhur nga autoritetet greke dhe prej myftinjve, si dhe me të gjithë ata që kishte përzgjedhur ambasadori shqiptar në Athinë. Konstatimet e kësaj përfaqësie ishin se një shumicë e madhe e myslimanëve që banonin në Epir dhe në Maqedoninë Perëndimore, deklarorin se ishin me origjinë turke dhe se dëshironin të përfshiheshin në procedurën e shkëmbimit të popullsisë. Vetëm disa grupe të kufizuara në numër pretendonin se kishin origjinë shqiptare dhe për këtë arsye kërkonin që të përjashtoheshin nga procedurat e shkëmbimit të popullsisë. Konkluzioni në të cilin arriti përfaqësia, ishte se vendi i origjinës së të interesuarve do të duhej të përbënte kriterin parësor për përjashtimin e tyre nga procedura e shkëmbimit, ndërsa duhej gjithashtu të merrej

¹⁷ *Dokumente për Çamërinë*, nr. 110, 18-194 dhe Mihalopoulos, *Çamët*, fq. 33-36.

¹⁸ Ladas, *The Exchange of Minorities*, fq. 384-385.

seriozisht parasysh deklarimi i qartë mbi ndërgjegjen kombëtare, gjuhën dhe si kriter dytësor, doket dhe zakonet¹⁹. Të njëjtën frymë kishin edhe udhëzimet që Komisioni Miks u dërgoi më vonë nënkomisioneve në zonat përkatëse, të cilët i ngarkonte me detyrën e grumbullimit të të dhënave të domosdoshme rast pas rasti, dhe evidentimin e personave që do të duhej të përjashtoheshin nga procedura e shkëmbimit të popullsive²⁰.

Këto vendime e shqetësuan dukshëm qeverinë shqiptare, e cila shikonte se konstatimet e para vinin në kundërshtim të plotë me synimet e saj. Siç rezulton nga një memorandum i Ministrit të Jashtëm Shqiptar të 12 Gushtit 1924²¹, argumentet e të cilit u përdorën më vonë për të mbështetur qëndrimet shqiptare para Këshillit të Lidhjes së Kombeve, pala shqiptare vinte në dyshim vlefshmërinë e metodologjisë që ndoqi delegacioni, duke mbështetur pikëpamjen se gjuha është ajo që duhej marrë ekskluzivisht parasysh për përcaktimin e origjinës së myslimanëve të Epirit, sepse nga njëra anë, kriteri i vendit të origjinës nuk mund të zbatohet për shqiptarët e Çamërisë, përderisa ata ishin autoktonë, dhe nga ana tjetër këto popullsi nuk kishin mundësi që të shprehnin lirshëm dëshirën e tyre për t'u përjashtuar nga shkëmbimi, meqenëse autoritetet greke kishin ushtruar mbi ta presione të forta dhe kishin marrë masa në mënyrë që t'i detyronin të largoheshin²². Të njëjtat argumente në lidhje me kriteret dhe vlefshmërinë e procedurave që zbatoheshin në kuadër të Komisionit Miks, u përsëritën prej palës shqiptare dhe gjatë diskutimit respektiv që u zhvillua në Këshillin e Lidhjes së Kombeve në shtator 1924, madje me tone më agresive²³. Delegacioni shqiptar kërkoi që të mos merrej parasysh dëshira e deklaruar e shumicës së çamëve për të emigruar, sepse sipas tij, kjo dëshirë ishte produkt i dhunës dhe i presioneve. Madje

¹⁹ Ladas, *The Exchange of Minorities*, fq. 386.

²⁰ Mihalopoulos, *Çamët*, fq. 39.

²¹ Dokumente për Çamërinë, nr. 184, fq. 340-352.

²² League of Nations, C. 399. 1924. VII, Geneva 18-8-1924.

²³ Hollësi mbi diskutimin e shtatorit, që u fokusua kryesisht rreth çështjes së kompetencave të Këshillit të Lidhjes për mbrojtjen e minoriteteve në Greqi, shih si më lart, Mihalopoulos fq. 40-45.

delegacioni pretendoi se shqiptarët e Epirit ishin viktimat kryesore të grupeve të grabitësve dhe terroristëve që po shkatërronin atë rajon²⁴. Qeveria greke nuk e kishte të vështirë t'i hidhte poshtë pretendimet shqiptare, përderisa vetë delegacioni treanëtarësh kishte konkluduar se faktori gjuhë e humbiste rëndësinë e tij në rajone me një përzierje kaq të madhe popullsish, siç ishin ato ku ishin kryer sondazhet dhe ku banorët, për ta pasur më të lehtë gjatë komunikimit mes tyre, njihnin më tepër se një gjuhë. Për sa i përket çështjes së shprehjes së lirë të vullnetit të myslimanëve, konstatimet përkatëse të përfaqësisë, ashtu siç ishin formuluar në raportin e qershorit, ishin të qarta dhe nuk mund të viheshin në dyshim²⁵.

Duke dashur të shprehë kundërshtimin e saj të plotë në lidhje me zhvillimet e qershorit, qeveria shqiptare u dërgoi letra si Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve Erik Drummond, ashtu dhe qeverive të Fuqive të Mëdha (Britanisë, Francës, Italisë), nëpërmjet të cilave, jo vetëm që vinte në dyshim vlefshmërinë e procedurës që ndoqi përfaqësia e posaçme që kishte vizituar Maqedoninë dhe Epirin, por, duke hedhur edhe një hap tjetër, njoftonte marrësit e këtyre letrave se “ndodhej nën presionin e fortë të opinionit publik që të vendoste shqiptarët që vinin nga Çamëria, në rajonet e Gjirokastrës ku banonin greqishtfolësit” dhe se “qeveria nuk mbante asnjë përgjegjësi për pasojat që mund të rridhnin”²⁶. Gjithsesi, dhe pavarësisht se i referohej opinionit publik, siç rezultoi nga një letër e Ministrit të Jashtëm Shqiptar, Sulejman Delvina, të dt. 21 Korrik 1924 drejtuar kryeministrit Fan Noli²⁷, Ministria, si mjet të vetëm për përballimin e gjendjes që do të krijohet nga një rezultat negativ për interesat shqiptare i punimeve të Komisionit Miks, propozonte që banorët

²⁴ Dokumente për Çamërinë, nr. 199, fq. 371-379. Shih edhe Divani, Greqia dhe minoritetet, fq. 227.

²⁵ League of Nations, C. 813.1924, VII, Geneva 5-12-1924.

²⁶ Dokumente për Çamërinë, nr. 175, 321-323, dhe nr. 180, fq. 328-331.

²⁷ Në Shqipëri ndërkohë ishte shfaqur lëvizja jetëshkurtër e Fan Nolit, që përmbysi Ahmet Zogun nga pushteti dhe e mbajti atë deri në dhjetor të po atij viti. Gjashtëmujori i dytë i 1924 karakterizohet nga një ashpërsim i dukshëm i taktikës së udhëheqjes shqiptare kundrejt të gjitha çështjeve që kishin të bënin me interesat greke.

greqishtfolës të Shqipërisë të detyroheshin për të emigruar në Greqi²⁸. Më vonë, Delvina do t'i drejtonte thirrje Ministrisë së Brendshme që t'u dërgonte udhëzime autoriteteve kufitare të juridiksionit të saj, që të mos u nxirrnin pengesa gjatë hyrjes dhe vendosjes në Shqipëri të të gjithë bashkatdhetarëve që vinin nga Greqia, në mënyrë që të shmangnin dërgimin e tyre në Turqi²⁹. Mesa duket këto iniciativa, e zemëruan tej mase Sekretarin e Përgjithshëm të Lidhjes së Kombeve, i cili iu përgjigj me tone të ashpra propozimeve shqiptare³⁰, ndërsa Avenol, Zëvendësekretar i Përgjithshëm, ia bëri të qartë përfaqësuesit shqiptar Benua Blinishti, se asnjë paralelizëm nuk mund të bëhej mes këtyre dy çështjeve, përderisa Shqipëria obligohej prej konventave ndërkombëtare për mbrojtjen e minoriteteve, dhe se deklarata të llojit “qeveria shqiptare nuk merr përsipër asnjë përgjegjësi për pasojat që do të sillte vendosja e shqiptarëve në rajonet e greqishtfolësve”, mund të kishin pasojat të pakëndshme për vetë qeverinë shqiptare, përderisa një qeveri e përgjegjshme, sigurisht që mbante përgjegjësi për ruajtjen e sigurisë në territorin e vet. Nga ana tjetër, Këshilli me të drejtë do të mund t'i konsideronte këto si një kërcënim indirekt³¹.

E vërteta është se në atë periudhë çamët e Epirit, duket se nuk kishin krijuar akoma një ndërgjegje të qartë kombëtare. Më shumë se shqiptarë apo turq, ata ishin dhe ndiheshin myslimanë. Feja ishte ajo që luante rol parësor për vetpërcaktimin e tyre. Kështu shpjegohet dhe konfuzioni i përgjithshëm që mbizotëronte fillimisht midis tyre në lidhje me atë se kush do të ishte në fund të fundit pozicioni që do të mbanin, domethënë a duhej të merrnin pjesë në procesin e shkëmbimit dhe të niseshin për në Turqi, apo të qëndronin në ato rajone ku ishin

²⁸ Dokumente për Çamërinë, nr. 170, fq. 315-316. Nuk duhet konsideruar thjesht si një koïncidencë kohore fakti se po atë periudhë, pra, që në verën e 1924, u ushtruan presione të forta mbi elementin grek të Shqipërisë, kryesisht për çështje ekonomike (abrogim i privilegjeve ekonomike të Himarës, shpronësim i ndërtesave dhe trojeve greke në Sarandë etj.).

²⁹ Isufi, “Politika e shtetit grek”, fq. 69.

³⁰ Dokumente për Çamërinë, nr. 175, fq. 321-323.

³¹ Po si më lart, nr. 181, fq. 332-334.

vendosur deri atëherë. Një tregues i qartë i këtij konfuzioni është edhe fakti se nga njëra anë ekzistonin grupe çamësh që mbronin idenë se nuk kishin asnjë lidhje me shqiptarët. Përkundrazi, në të kaluarën kishin luftuar përkrah turqve dhe në mënyrë të përsëritur kishin shfaqur dëshirën e tyre për të emigruar në Turqi. Rrjedhimisht, vendimi i qeverisë greke për t'i përjashtuar nga procesi i shkëmbimit të popullsisë, madje në momentin që mjaft prej tyre, në pritje për t'u nisur drejt Turqisë, kishin shitur pronat e tyre dhe ishin gati për t'u larguar, vinte në kundërshtim me dëshirën e tyre të deklaruar qartë³². Por në të njëjtën kohë, kishte dhe grupe të tjera që parashtronin pretendime të kundërta: domethënë, me gjithë faktin se ishin shqiptarë dhe nuk kishin asgjë të përbashkët me turqit, autoritetet greke, pretendonin ata, i trajtonin si të tillë, duke vendosur mbi ta të njëjtat masa kufizuese si për turqit, kryesisht për çështje të pronësisë³³.

Pikërisht këtë konfuzion të përgjithshëm dhe pavendosmërinë që mbizotëronte midis çamëve duket se shpejtuan për ta shfrytëzuar si qeveria shqiptare ashtu dhe qeveria greke, në mënyrë që secila prej tyre të impononte zgjidhjen që i interesonte më shumë. Qeveria shqiptare kishte interes të drejtpërdrejtë që çamët të qëndronin në shtëpitë e tyre, duke besuar se do të mund t'i tërhiqte lehtë dhe t'i përdorte si kundërpeshë për minoritetin grek që jetonte në pjesën jugore të vendit. Pra, për të arritur qëllimet e saj, kishte filluar që herët të zhvillonte një aktivitet të dendur propagandistik, duke përdorur persona dhe grupe të veçanta në Epir, të cilët kishin si objektiv kryesor, të kultivonin te çamët identitetin kombëtar shqiptar dhe t'i bindnin ata të mos merrnin pjesë në shkëmbimin e popullsisë, duke deklaruar se janë me origjinë

³² AYE, 1925, G/68/X, nr. pr. 2345, Administrata e Përgjithshme e Epirit për MPJ, Janinë, 12-1-1925.

³³ AYE, 1925, G/68/X, nr. pr. 45666, Dendramis për Ministrinë e Jashtme, Gjenezë 21-11-1924. Shih edhe Dokumente për Çamërinë, nr. 181, fq. 332-334, ku shtjellohen mjaft raporte me përmbajtje të ngjashme, drejtuar ose qeverisë greke ose qeverisë shqiptare, dhe i takojnë periudhës kohore nga fundi i 1923 dhe në vazhdim.

shqiptare³⁴. Njëkohësisht, ashtu siç përmendëm edhe më lart, kishte filluar një fushatë propagandimi i çështjes së çamëve në nivel ndërkombëtar, me objektiv kryesor Lidhjen e Kombeve dhe Qeveritë e Fuqive të Mëdha, duke denoncuar autoritetet greke se po zbatonin masa të shumëllojshme presioni kundër tyre, kryesisht të karakterit ekonomik, me qëllim që t'i terrorizonin dhe t'i detyronin të largoheshin, dhe në pronat e tyre të vendosnin refugjatë që vinin nga Azia e Vogël. Dhe me të vërtetë, dukej se propaganda shqiptare kishte filluar të jepte frytet e veta: ndërsa në fillim, ashtu siç kishte konstatuar edhe Komisioni Miks, shumica e myslimanëve kishte shfaqur dëshirën për t'u përfshirë në shkëmbimin e popullsive³⁵, më vonë ata filluan të ndryshonin mendje dhe të tentonin me çdo mënyrë të qëndronin në shtëpitë e tyre.

Pala greke, sigurisht që gjykoj se nuk duhej të qëndronte indiferente përballë kësaj gjendjeje të re që po tentonte të krijohet. Duke e ditur se myslimanët çamë të Epirit mund të shndërroheshin në një subjekt efikas të propagandës shqiptare dhe në një shkas të përhershëm ndërhyrjesh në çështjet e brendshme të Greqisë, duke kuptuar ndërkohë problemet dhe rreziqet që do të krijoheshin prej një perspektive të tillë, u përpoq, që në vitin 1924, të krijonte një rrymë migratore çamësh drejt Turqisë me dëshirën e tyre. Si element kryesor për t'ia arritur këtij qëllimi, ajo përdori myftinjët, të cilët duket se kishin një ndikim të fortë mbi popullsinë, por edhe faktorë të tjerë lokalë, të cilët, për vetë natyrën e marrëdhënieve dhe të ndikimit të tyre mbi parinë e myslimanëve, do të mund t'u ndryshonin mendjen njerëzve³⁶. Por meqenëse ishte angazhuar

³⁴ AYE, 1925, G/68/X, nr. pr. 4258, Administrata e Përgjithshme e Epirit për Ministrinë e Jashtme, Janinë 18-3-1925. Shih edhe Dokumente për Çamërinë, nr. 66, fq. 113, ku Ministria e Brendshme Shqiptare informon atë të Jashtme, në Gusht 1923, se në bashkëpunim me organizatën "Çame" ishin marrë masat e duhura që të këshilloheshin çamët që në asnjë mënyrë të mos pranonin të emigronin në Turqi.

³⁵ Autoritetet greke llogarisnin atëherë se, ata që dëshironin të emigronin në Turqi përbënin pothuaj 9/10 e numrit të përgjithshëm. AYE, 1925, G/68/X, nr. pr. 2345, Administrata e Përgjithshme e Epirit për Ministrinë e Punëve të Jashtme, Janinë, 12-1-1925.

³⁶ AYE, 1925, G/68/X, nr. pr. 1653, Administrata e Përgjithshme e Epirit për MPJ, Janinë, 26-1-1925.

para Lidhjes së Kombeve që të mos ndërmernte asnjë veprim, i cili do të rezultonte fakt i kryer para përfundimit të punimeve dhe shpalljen e një vendimi përfundimtar nga ana e Komisionit Miks në lidhje me shkëmbimin³⁷, qeveria greke u dha udhëzime të qarta autoriteteve lokale që t'i shmangeshin çfarëdolloj mase që mund të ekspozonte sinqeritetin e qeverisë dhe të konsiderohej si ushtrim presioni³⁸, duke pezulluar madje edhe nisjet e çamëve për në Turqi, që ndërkohë ishin programuar. Veprimtaria e saj u kufizua detyrimisht në përpjekjet që çamët të ndryshonin mendje dhe në forcimin e rrymës që ishte në favor të shkëmbimit. Gjithsesi, duhet theksuar se, Greqia, me qëndrimin që mbante, kishte arritur deri në atë moment që të fitonte besimin e funksionarëve të Lidhjes së Kombeve. Raportuesi zyrtar për çështjen e çamëve, Spanjollli Kiniones de Leon, lavdëroi qëndrimin e qeverisë greke dhe konsekuencën e saj kundrejt detyrimeve të veta³⁹.

Por, le t'u kthehemi diskutimeve që po zhvilloheshin paralelisht në Lidhjen e Kombeve. Konkluzionet në të cilat kishte arritur përfaqësia treanëtarëshe nga vizita e saj në Epir në muajin Maj, por edhe mosmarrëveshjet dhe kundërakuzat e vazhdueshme midis palës greke dhe palës shqiptare, e çuan më në fund Këshillin e Lidhjes së Kombeve në vendimin që mori në shtator 1924, domethënë ta trajtonte të gjithë problemin si një çështje që kishte të bënte me zbatimin e konventës për mbrojtjen e minoriteteve dhe të mblidhte më shumë informacione respektive. Për këtë qëllim, me vendimin e tij të datës 11 Dhjetor të po atij viti, emëroi tre anëtarët asnjans të Komitetit Miks për Shkëmbimin e Popullsive, suedezin Erik Ekstrand, spanjollin Manuel de Lara dhe danezin Karl Widding, si të mandatuar të tij për mbrojtjen e minoritetit shqiptar në Greqi dhe u ngarkoi detyrën që të mblidhnin më shumë informacione në lidhje me këtë çështje⁴⁰. Ata, nga ana e tyre, caktuan si agjentë të tyre, kryetarët e dy nënkomisioneve që ishin ngritur për zbatimin

³⁷ League of Nations, C. 813.1924, VII, Geneva 5-12-1924.

³⁸ AYE, 1925, G/68/X, nr. pr. 7847, Palis për Ministrinë e Jashtme, Janinë 10-6-1925.

³⁹ Divani, Greqia dhe Minoritetet, fq. 229-230

⁴⁰ League of Nations, C. 816 (1). 1924. VII, Geneva 11-12-1924.

në vend të masave të shkëmbimit, të nënkomisionit të parë me seli në Selanik dhe të nënkomisionit të katërbëdhjetë me seli në Pargë⁴¹, duke i ngarkuar me detyrën shtesë të mbledhjes dhe dërgimit në Komisionin Miks në Stamboll të të gjitha kërkesave që do të depozitoheshin për t'u përjashtuar nga shkëmbimi si dhe të dhënave të domosdoshme për vërtetësinë e origjinës së kërkuësve, por edhe të ankesave, nëse do të kishte nga ana e të interesuarve⁴².

Ndërkohë, konfuzioni që mbretëronte në radhët e popullsisë myslimane të Epirit, veprimtaria e propagandës shqiptare, reagimi grek dhe tensioni që ishte krijuar në përgjithësi në atë rajon, ishte e natyrshme që do të ndikonte në zhvillimin normal të punës së nënkomisionit⁴³. Mosmarrëveshje të thella u shfaqën midis të plotfuqishmit grek dhe atij turk në nënkomisionin e 14-të. Më konkretisht, përfaqësuesi turk mbronte pikëpamjen se në shkëmbimin e popullsisë duhej të përfshiheshin vetëm ata që e kishin origjinën nga Turqia. Pra, ajo që duhej të kërkonte nënkomisioni, ishte verifikimi i origjinës turke të myslimanëve. Në ato raste që kjo nuk mund të verifikohet, do të mjaftonte gjuha, domethënë nëse flisnin turqisht, ose ndërgjegjja kombëtare, nëse ajo ishte qartësisht e deklaruar. Dëshira e myslimanëve të Epirit që të përfshiheshin në shkëmbimin e popullsisë, nuk duhej konsideruar si kriter, sepse kjo dëshirë kishte të bënte më shumë me stimuj ekonomikë se sa me stimuj etnikë, dhe kjo nga vetë gjendja e mjerueshme në të cilën ndodheshin. Përkundrazi, përfaqësuesi grek mbronte pikëpamjen se edhe në bazë të udhëzimeve që kishin marrë nga Komisioni Miks, qëllimi kryesor i nënkomisionit ishte hulumtimi mbi origjinën shqiptare të myslimanëve, duke qenë se ai konsideronte se ndërgjegjja e tyre kombëtare ishte deklaruar qartë kur ata, kolektivisht, kishin shfaqur dëshirën për të emigruar. Ishte e pamundur që të përcaktohet origjina me ndihmën e elementëve të tjerë, përderisa popullsia e Epirit në fakt fliste tre gjuhë. Si autoktonë të Çamërisë duhej të konsideroheshin vetëm ata që do të vërtetonin prejardhjen e tyre

⁴¹ Societe des Nations, C. 111. M. 52. 1925. I, Geneve 3-3-1925.

⁴² Societe des Nations, C. 213. M. 72. 1925. I, Geneve 20-3-1925.

⁴³ Në mënyrë më analitike për ecurinë e punës së nënkomisionit dhe mosmarrëveshjeve mes anëtarëve të tij, shih Mihalopoulos, Çamët, fq. 48-57.

shqiptare. Kryetari i nënkomisionit të 14-të, Danezi Karl Bratli, ishte më shumë në favor të një zgjidhjeje kompromisi: konsideronte se ata myslimanë të Çamërisë, gjuha, doket dhe zakonet e të cilëve ishin të provuara si shqiptare, do të mund t'i referoheshin origjinës shqiptare, por ata, dëshira e të cilëve për t'u larguar ishte e sinqertë dhe e vetvetishme, duhej të përfshiheshin në shkëmbim⁴⁴.

Pra, meqenëse mosmarrëveshjet midis anëtarëve të nënkomisionit mund të rrezikonin përfundimin e punimeve dhe marrjen e një vendimi përfundimtar për zgjidhjen e çështjes, tre anëtarët asnjans të Komisionit Miks dhe të mandatuar nga Lidhja e Kombeve, vendosën që të vizitonin vetë Epirin, në mënyrë që të kontrollonin në vend rezultatet e punës së nënkomisionit dhe ta verifikonin gjendjen nga afër, vizitë, e cila u realizua më së fundi në qershor të vitit 1925. Ajo që konstatuan të tre anëtarët nga takimet që patën me përfaqësues të ndryshëm të çamëve, në thelb, nuk ishte shumë larg konkluzioneve që kishte arritur edhe përfaqësia treanëtarëshe e Lidhjes së Kombeve vetëm një vit më parë: gjendja ishte me të vërtetë kaotike, popullsia nuk ia kishte idenë për origjinën e saj, mbi të gjitha e ndjenin veten myslimanë, ndërsa prapa dëshirës së tyre për të emigruar fshihej më shumë pasiguria për të ardhmen, shqetësimi për fatin që do të kishte pasuria e tyre e patundshme në shtetin grek dhe shpresa për një fat më të mirë në Turqi⁴⁵, dhe më pak një shprehje e qartë e ndërgjegjes së tyre kombëtare⁴⁶. Për Komisionin, mënyra më e mirë për t'u përballur me këtë çështje do të ishte gjetja e një zgjidhjeje kompromisi midis dy palëve, domethënë, largimi për në Turqi i të gjithë atyre që me të vërtetë e dëshironin diçka të tillë dhe përjashtimi i të tjerëve nga masat për shkëmbimin e popullsisë. Duket se qeveria greke në atë periudhë,

⁴⁴ AYE, 1925, G/68/X, nr. pr. 3639, Petihakis për Ministrinë e Jashtme, Janinë 11-3-1925.

⁴⁵ Sipas nenit 14 të Marrëveshjes greko-turke mbi Shkëmbimin, çdo person që do të shkëmbehej, do të merrte në vendin ku emigronte një pronë me vlerë të njëjtë dhe të po asaj natyre me atë që linte pas. Pentzopoulos, *The Balkan Exchange*, fq. 68, dhe Ladas, *The Exchange of Minorities*, fq. 792.

⁴⁶ Ladas, si më lart fq. 389

e gjendur përballë vështirësive dhe vonesave që ishin shfaqur, ishte e gatshme të pranonte kompromisin, me kusht që deklarimi i ndërgjegjes turke dhe i dëshirës për të emigruar do të ishin kushte të mjaftueshme⁴⁷. Tre të mandatarit e Lidhjes së Kombeve llogarisnin se përqindja e atyre që do të vendosnin përfundimisht për të emigruar, sipas të gjitha gjasave mund të arrinte në 40% të totalit të popullsisë myslimane. Përkundrazi, autoritetet greke vlerësonin se do të largoheshin pothuajse 75% e totalit të myslimanëve. Kjo rrymë emigratore, madje mund edhe të shtohet, nëse do të kishte një deklaratë zyrtare nga ana e qeverisë turke se ishte e predispozuar të pranonte vendosjen në vend të një numri të kufizuar myslimanësh, rreth 10 mijë personash. Pala greke shpresonte se, nëse do të arrihej që të nisej qoftë dhe një numër i vogël me çamë, atëherë me siguri shembullin e tyre do ta ndiqnin me shpejtësi dhe ata që do të mbeteshin⁴⁸.

Me të vërtetë, qeveria greke ndërmori iniciativat e përshtatshme në drejtim të qeverisë turke, me qëllim që t'i shkëpuste një premtim që do të kënaqte pritshmëritë e veta, por qeveria shqiptare nga ana e saj, u përpoq që t'i zhvleftësonte këto nisma, duke tentuar që të bindte Ankaranë të mos pranonte për shkëmbim myslimanë nga Çamëria. Më në fund, qeveria turke u mjaftua të informonte, në Korrik 1925, të ngarkuarin me punë të Greqisë në Ankara, Ioannis Politis, se do të pranonte në territorin e saj, deri dhe 5.000 myslimanë të Thesprotisë, pra d.m.th. një numër që nuk ishte sa e kishte kërkuar Athina, por ishte mjaft i kënaqshëm dhe sidomos, do të mund të hapte rrugën për zgjidhjen e problemit në të ardhmen. Autoritetet greke kishin bindjen se, nëse do të nisej ky grupim i parë, atëherë shpejt do të niseshin dhe grupe të tjera⁴⁹. Qeveria shqiptare u informua me mjaft vonesë për vendimin e qeverisë turke dhe ajo menjëherë protestoi si në Komisionin Miks në Stamboll, ashtu dhe te Sekretari i Përgjithshëm i Lidhjes së Kombeve, me justifikimin se ishte në kundërshtim të plotë, si

⁴⁷ AYE, 1925, G/68/X, nr. pr. 7691, Ministria e Jashtme për Administratën e Përgjithshme të Epirit, Athinë 14-6-1925.

⁴⁸ AYE, 1925, G/68/X, nr. pr. 7691, Palis për Ministrinë e Jashtme, Janinë 7-6-1925.

⁴⁹ Mihalopoulos, Çamët, fq. 61.

me deklaratën e palës greke të janarit 1923, ashtu dhe me vendime të mëparshme të vetë Komisionit. Pala shqiptare besonte se marrëveshja greko-turke përfshinte shkëmbimin e 5.000 myslimanëve të Çamërisë me 5.000 grekë të Stambollit, besonte gjithashtu se shkaqet që Turqia e pranoi ishin kryesisht ekonomike, përderisa pronat e çamëve do të përfshiheshin në përllogaritjen totale të pronave greke dhe turke, ashtu siç parashikonte marrëveshja mbi shkëmbimin e popullsisë⁵⁰.

Është karakteristik fakti se kur u informua mbi përmbajtjen e diskutimeve përkatëse dhe mbi këtë marrëveshje në muajt e fundit të vitit 1925, ambasadori shqiptar në Athinë, Mit'hat Frashëri, u shqetësua shumë dhe në raportet e njëpasnjëshme të tij për Tiranën, sugjeroi ashpërsim të qëndrimit të qeverisë shqiptare dhe marrje masash, në mënyrë që të pengohej një zhvillim i tillë. Propozimi i parë që bëri ishte që në vend të shkëmbimit të çamëve me grekë të Stambollit, të bëhej shkëmbimi i tyre me grekë të Shqipërisë, ose të paktën të kërcënohej seriozisht Greqia se, nëse ajo do të avanconte me zbatimin e marrëveshjes me Turqinë, atëherë dhe Shqipëria nga ana e saj, do të ishte e detyruar të merrte masa respektive kundrejt minoritetit grek. Kjo masë e fundit do të shërbente njëkohësisht edhe si një provë kundrejt çamëve se shteti shqiptar interesojë për fatin e tyre, dhe në këtë mënyrë do të inkurajoheshin në përpjekjet e tyre për t'u bërë ballë taktikave greke. Në mënyrë që pala shqiptare, të tregonte se ishte e vendosur që të avanconte drejt zbatimit të kërcënimeve të veta, Frashëri propozoi që autoritetet vendore shqiptare të fillonin regjistrimin e pronave të grekëve dhe paralelisht të nxirrej një urdhëresë e përgjithshme e cila do të ndalonte çdo lloj shitblerjeje të tyre⁵¹. Sigurisht, qeveria shqiptare nuk mori parasysh asnjë prej këtyre propozimeve, sepse në konjunkturën e dhënë kohore ajo i kishte të gjitha arsyet që t'u përmbahej toneve të ulëta në marrëdhëniet e saj me Greqinë, përderisa ndryshimi i skenës politike që kishte ndërmjetësuar ndërkohë në Athinë e kishte ndryshuar me shpejtësi gjendjen e deriatëhershme.

⁵⁰ Dokumente për Çamërinë, nr. 248-249, fq. 456-458

⁵¹ Si më lart, nr. 245, fq. 451-453.

Kështu që, kur Mit'hat Frashëri filloi të protestonte me tone të ashpra për neglizhencën me të cilën u trajtuan propozimet e tij, madje duke arritur deri aty sa të akuzonte qeverinë shqiptare se politika që ndiqte tradhtonte interesat e vendit, Ministria e Punëve të Jashtme e detyroi më në fund që të jepte dorëheqjen, e cila u pranua në Maj të vitit 1926⁵².

Me të vërtetë, zhvillimet e brendshme politike në Greqi zhvleftësuan çdo mundësi materializimi të marrëveshjes greko-turke dhe së bashku me të, çdo perspektivë përfitimi të shtetit grek prej saj: më 25 qershor 1925 gjenerali Theodoros Pangalos rrëzoi me grusht shteti qeverinë e ligjshme të Mihalakopulos dhe rrëmbeu pushtetin në Greqi. Vetë gjenerali ishte mik i deklaruar i shqiptarëve, por mbi të gjitha, ishte i vendosur të përmirësonte me çdo mënyrë marrëdhëniet mes dy vendeve, duke shpresuar se marrëdhëniet normale politike do të sillnin përfitime të rëndësishme ekonomike për Greqinë, në radhë të parë rilindjen ekonomike dhe zhvillimin tregtar të Epirit⁵³. Shenjat e para të kthesës në qëndrimin zyrtar grek u shfaqën në janar të vitit 1926, kur ambasadori i sapoemëruar i Greqisë në Tiranë, gjeneral Kondulis, iu drejtua me një letër më 13 të atij muaji qeverisë shqiptare, duke e siguruar në emër të kryetarit të qeverisë greke Theodoros Pangalos, se në marrëdhëniet greko-shqiptare do të frynte tashmë një erë e re. Pak ditë më vonë, më 18 janar, ambasadori shqiptar në Athinë, Mit'hat Frashëri, mori premtimin e Ministrit të Jashtëm Grek se do të shqyrtonte çështjen e shkëmbimit të Çamëve, ndërsa vetë Pangalos i deklaroi se myslimanët çamë do të përjashtoheshin nga shkëmbimi⁵⁴. Një muaj më vonë, në shkurt të po atij viti, u njoftua edhe zyrtarisht vendimi për përjashtimin e të gjithë shqiptarëve të Epirit nga masat e shkëmbimit të detyrueshëm si dhe për amnistimin e çamëve që

⁵² L. Malltezi, "Mit'hat Frashër, Ministër Fuqiptotë i Shqipërisë në Athinë (1923-1926)", *Eksluzive* 31, Nëntor 2002, 102-105.

⁵³ Në mënyrë më analitike për synimet e qeverisë Pangalos për sa u përket marrëdhënieve greko-shqiptare, shih Mihalopoulos, Çamët, fq. 65-74.

⁵⁴ Isufi, "Politika e shtetit grek", fq. 73.

akuzoheshin për zhvillim propagande politike, duke i dhënë kështu një zgjidhje përfundimtare çështjes, por një zgjidhje që kënaqte plotësisht palën shqiptare. Si shkëmbim, Greqia i shkëputi premtimin qeverisë shqiptare për funksionimin pa pengesa të shkollave të minoritetit grek në Shqipëri, një premtim, për të cilin duhet theksuar se asnjëherë nuk u zbatua në praktikë. Njëkohësisht u arrit dhe një marrëveshje për dërgimin e studentëve shqiptarë në shkolla ushtarake greke⁵⁵. Në kuadër të këtyre zhvillimeve, Këshillit të Lidhjes së Kombeve nuk i mbeti gjë tjetër përveçse të shprehte kënaqësinë e tij për vendimin e palës greke dhe të tërhiqte mandatin që u kishte dhënë në dhjetor të vitit 1924 tre anëtarëve asnjans të Komisionit Miks për mbrojtjen e minoritetit shqiptar në Greqi. Si rezultat, çështja konsiderohej tashmë e mbyllur⁵⁶.

2. Integrimi i çamëve në shtetin grek

Vendimi i Theodoros Pangalos për të përjashtuar çamët e Epirit nga shkëmbimi, ishte përcaktues për ecurinë e mëtejshme të kësaj çështjeje, sepse ravijëzoi kalimin nga faza e parë në një fazën e dytë, e ndryshme nga e para për sa i përket përmbajtjes dhe intensitetit me të cilin ajo u shfaq. Thelbi i çështjes zhvendoset tashmë nga përcaktimi i origjinës dhe i identitetit etnik të popullsisë myslimane të Epirit, dhe nga përfshirja ose jo e kësaj popullsie në procesin e shkëmbimit të detyrueshëm, në procesin e integrimit të saj në shtetin grek dhe në respektimin ose jo të të drejtave të saj nga autoritetet greke. Madje, çështja mori përmasa të paparashikuara, sepse në këtë fazë të dytë ndërhyrja e qeverisë shqiptare ishte shumë më aktive si mbrojtëse dhe si ndërmjetëse e paftuar e çamëve. Qeveria shqiptare madje shpejtoi ta

⁵⁵ ASMAE, Albania 1926, 730/429, no. 570/32, Brambilla për Ministero Affari Esteri, Athinë 8-2-1926 dhe no. 721/24, Brambilla për Ministero Affarti Esteri, Athinë 12-2-1926. Shih edhe Mihalopoulos, Çamët, fq. 74

⁵⁶ Societe des Nations, C. 179. 1926. I, Geneve 15-3-1926.

lidhte çështjen me problemin e pronave shqiptare të shpronësuara, për të cilën kishte interes ekonomik të drejtpërdrejtë. Kështu që, nga një çështje “greko-turke” tashmë shndërrohet në një çështje që lidhet me marrëdhëniet greko-shqiptare, te të cilat do të ndikojë në një masë të madhe në periudhën pasardhëse. Prezenca e myslimanëve çamë në Epir përbënte një rast unik dhe një kartë të fortë negociimi që pala shqiptare do ta përdorte për të arritur një rregullim të kënaqshëm të synimeve të saj për sa i përket çështjes së pronave.

Ekzistenca e pronës së madhe përbënte një problem kolosal për shtetin grek dhe ky problem u shfaq që me bashkimin e Thesalisë, në vitin 1881, ndërsa integrimi i Epirit dhe Maqedonisë në vitin 1913 në shtetin grek, e bënë këtë problem akoma më të mprehtë. Qeveritë greke, që në vitin 1917 kishin tentuar të përballeshin me gjendjen, por pa ndonjë sukses të dukshëm. Por mbërritja në vitin 1922 e pothuaj 1,5 milionë refugjatëve nga Azia e Vogël dhe detyrimi që kishte marrë përsipër shteti, kundrejt Komisionit të Trajtimit të Refugjatëve për gjetjen e menjëhershme dhe dhënien e 5 milionë dynymëve tokë për këta refugjatë, i imponuan shtetit një rindarje rrënjësore të tokës, në kuadrin e së cilës u shpronësuan jo vetëm pronat e mëdha por edhe ato mesatare⁵⁷. Në këtë kuadër u përfshinë edhe pronat e shqiptarëve, pronarë të mëdhenj tokash, që banonin kryesisht në Epir, në Thesali dhe në Maqedoninë Perëndimore dhe të cilët ishin larguar në Shqipëri, bile që në momentin kur këto rajone u përfshinë në shtetin grek. Shumë prej tyre ndërkohë, ishin shndërruar në faktorë të rëndësishëm politikë, të aftë jo vetëm për të ndikuar por edhe për të ushtruar presion mbi qeverinë shqiptare që të përpiqej t’u shërbente interesave të tyre⁵⁸. Këtyre

⁵⁷ Masat për shpronësim u zbatuan në bazë të një Dekretligji të dt. 15 Shkurt 1923 “Për rehabilitimin e kultivuesve pa tokë”, i cili parashikonte dhënien e pronave publike, bashkiake dhe vendore si dhe shpronësimin e detyrueshëm të tokave private.

⁵⁸ Një përfaqësues i rëndësishëm dhe udhëheqës i këtij grupimi politikanësh Shqiptarë, ishte Xhaferr Villa, Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Jashtme Shqiptare. I interesuar personalisht për çështjen, me cilësinë e ish pronarit që u shpronësua në bazë të legjislacionit agrar, ishte jo vetëm nxitësi kryesor i një fushate të ethshme antigreke nëpërmjet shtypit Shqiptar, por edhe përkrahte nevojën e marrjes së masave të ashpra nga ana e qeverisë shqiptare kundër Greqisë, siç ishte

pronave të shtetasve shqiptarë, iu shtuan më vonë edhe sipërfaqet e mëdha të tokave të shqiptarëve që u përjashtuan nga shkëmbimi dhe që qëndruan në territorin grek, sipërfaqe që ju nënshtruan zbatimit të përgjithshëm të masave të shpronësimit.

Gjatë periudhës së normalizimit relativ të marrëdhënieve greko-shqiptare, nën regjimin e Th. Pangalos, midis Greqisë dhe Shqipërisë u nënshkruan katër marrëveshje, prej të cilave njëra ishte “Mbi Vendosjen dhe Shërbimin Konsullor”⁵⁹. Për fat të keq, neni 3 i kësaj marrëveshjeje parashikonte se “në rast të shpronësimit të detyrueshëm apo rekuizimit në një prej dy shteteve, shtetasit e shtetit tjetër nuk do t’i nënshtroheshin nga kjo pikëpamje një statusi më pak të favorshëm nga ai të cilit i nënshtroheshin vendasit apo nënshtetasit e çfarëdo lloj vendi të tretë”⁶⁰, gjë që do të thoshte se shtetasit shqiptarë fitonin të drejtën për t’u trajtuar në mënyrë më të favorshme se Grekët, respektivisht të njëjtë me atë që u ishte rezervuar Britanikëve, Francezëve dhe Italianëve⁶¹. Por ndërkohë, duke marrë parasysh faktin se në total pronat shqiptare që ishin shpronësuar ishin mjaft të mëdha - Ministria Greke e Bujqësisë i llogariste në pothuaj një milion dynym, të cilave duhet t’u shtohet edhe një numër i

p.sh. mbyllja e Ambasadës Shqiptare në Athinë dhe kufizimi i numrit të shkollave të minoritetit grek që funksiononin në Shqipëri. AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 3238, Kokotakis për Mihalakopoulos, Tiranë 8-3-1928.

⁵⁹ Për tekstin e marrëveshjes shih Dh. Mihalopoulos, Marrëdhëniet Greqi – Shqipëri 1923 -1928, Selanik fq. 175-212. Tre marrëveshjet e tjera ishin “Konventë mbi ekstradimin e kriminelëve”, “Mbi shtetësinë” që rregullonte raste të shtetësisë së diskutueshme dhe “Marrëveshje mbi Tregtinë dhe Marinën” me të cilën synohej shtimi i shkëmbimeve tregtare.

⁶⁰ AYE, 1928, A/4/I, Convention Concernant l’Etablissement et le Service Consulaire entre la Republique Hellenique et la Republique Albanaise, Athenes 13-10-1926.

⁶¹ Në përgjithësi, pronarët e pronave të shpronësuar përfitonin shumën e dëmshpërblimit në obligacione shtetërore me interes 6%. Përjashtim pati për pronarët e huaj, Britanikë, Francezë dhe Italianë, për të cilët shteti grek ishte i detyruar – sipas marrëveshjeve të veçanta - të paguante në të holla, shuma 14 herë më të larta nga ato që u paguante pronarëve grekë. Historia e Kombit Grek, Athinë 1978, vëll. 15, fq. 297. G. Petropoulos, “Shkëmbimi i detyruar i popullsisë: Rregullime paqësore greko-turke, 1922 – 1930”, në vëll. Eleftherios Venizellos. Shoqëria-Ekonomia-Politika në epokën e tij, Athinë 1989, fq. 461.

konsiderueshëm shtëpish, mullinjsh etj. – kostoja financiare që i duhej të përballonte shteti grek nga një trajtim i tillë i diferencuar i shqiptarëve, do të ishte e papërballueshme për të, në mos asgjësuese⁶². Për këtë arsye⁶³, kjo marrëveshje nuk u votua nga Parlamenti Grek, gjë që ndikoi negativisht në klimën normale që ishte kultivuar gjatë periudhës së mëparshme disamujore në marrëdhëniet mes dy vendeve. Qeveria shqiptare nga ana e saj, kishte shpejtuar të ratifikonte menjëherë marrëveshjen, për vetë faktin se kishte përfitime kolosale ekonomike prej saj⁶⁴. Ndërkohë, në Greqi ishte përmbysur regjimi ushtarak i Pangalos dhe qeveria e ligjshme pasardhëse që erdhi në fuqi nuk ishte e predispozuar t'u bënte kaq lëshime shqiptarëve dhe të merrte përsipër sakrifica të papërballueshme financiare, madje në momentin që shteti shqiptar tregonte se nuk ishte i predispozuar të përmbushte detyrimet që kishte marrë përsipër në rrafsh ndërkombëtar për respektimin e të drejtave të minoritetit grek që jetonte në pjesën jugore dhe, shumë më tepër se aq, nuk po i mbante premtimet që kishte dhënë për funksionimin pa pengesa të shkollave greke⁶⁵. Kjo solli si rezultat që çështja e kompensimit të pronave shqiptare të mbetej pezull gjatë gjithë periudhës midis dy Luftërave, fakt që ndikoi shumë në krijimin e një klime mosbesimi në marrëdhëniet midis dy vendeve, duke e bërë njëkohësisht më të vështirë zgjidhjen edhe të çështjeve të tjera që ishin në interes të dy palëve.

Në këtë klimë pra, prezenca e çamëve në Thesproti përbënte një mjet të fuqishëm presioni në dispozicion të qeverisë shqiptare, e cila shpejtoi ta shfrytëzonte në nivelin maksimal të mundshëm.

⁶² AYE, 1928, A/4/I, nr. pr. 4343, Politis për Mihalakopoulos, Athinë 17-4-1928.

⁶³ AYE, 1928, A/4/I, nr. dok. 992, Th. Sofoulis, kryetar i Parlamentit për Ministrinë e Jashtme, Athinë 3-6-1927. Tri marrëveshjet e tjera, megjithëse u votuan nga Parlamenti, nuk u ratifikuan menjëherë, sepse katër marrëveshjet, në vija të përgjithshme, konsideroheshin si një e tërë dhe nuk ishte e lehtë për palën greke që ndonjëra prej tyre të hynte veças në fuqi. AYE, 1928, A/4/I, pa nr. pr., Shënim i Drejtorisë A' Politike, Athinë 9-8-1928.

⁶⁴ Për hollësi, shih Mihalopoulos, Çamët, fq. 88 e në vazhdim.

⁶⁵ AYE, Tetor 1927-1928, A/4/I, nr. pr. 207, Ministria e Jashtme për Ambasadën në Tiranë, Athinë 11-1-1928.

Përpjekjet dhe gjithë veprimtaria propagandistike e qeverisë shqiptare u zhvilluan përreth dy boshteve kryesore: boshti i parë kishte lidhje me kushtet e jetesës së çamëve dhe zbatimin, sipas palës shqiptare, të masave ekonomike dhe administrative kundër tyre nga ana e autoriteteve greke, ndërsa boshti i dytë lidhej me kërkesën për hapje shkollash në gjuhën shqipe në fshatra ku jetonte popullsi shqiptare. Më konkretisht, pala shqiptare akuzonte shtetin grek se shkelte të drejtën bazë mbi pronësinë, përderisa kishte ndërmarrë shpronësime masive të çamëve në momentin që nuk ishte vendosur akoma përfundimisht nëse ata do i nënshtroheshin shkëmbimit apo jo. Në tokat dhe në ndërtesat që ishin shpronësuar atëherë, ishin vendosur refugjatë nga Azia e Vogël dhe si rezultat i kësaj, çamët që u përjashtuan nga shkëmbimi pas vendimit të Pangalos, privoheshin jo vetëm nga prona e tyre por edhe nga mjetet më elementare të jetesës dhe ishin në gjendje të mjeruar ekonomike⁶⁶. Për sa u përket numrit të refugjatëve që ishin vendosur në këto zona, i plotfuqishmi shqiptar në nënkomisionin e 14-të të Epirit, Qenan Mesare, në një raport të tij për kryetarin e Komisionit Miks për Shkëmbimin, Manuel de Lara, bënte fjalë për zaptim të 3.419 shtëpive të myslimanëve (kundrejt vetëm 535 të të krishterëve) dhe për vendosje të 1.943 familjeve të refugjatëve në Çamëri⁶⁷. Pothuajse në të njëjtën periudhë (në prill të vitit 1926), sipas Ministrisë së Jashtme Greke, në Çamëri ishin vendosur pothuaj 1.300 familje refugjatësh, prej të cilave 300 në Igumenicë⁶⁸. Për më tepër, autoritetet greke, me gjithë garancitë e njëpasnjëshme që kishin dhënë, akuzoheshin se vazhdonin të përdornin metoda të ndryshme për t'i detyruar çamët që të largoheshin. Theks të veçantë pala shqiptare vinte te rastet e disa fshatrave: në Gardhiki, ndërsa në të kaluarën numëroheshin 400 familje çamësh, tani kishin mbetur vetëm 10-15 familje, në fshatin Dragumi, nga 80 familjet kishin mbetur 30, në Margariti, nga 700 familjet kishin mbetur 300, në Karbunarë, nga

⁶⁶ Shih për ilustrim Dokumente për Çamërinë, nr. 276, fq. 521-522 dhe nr. 290, fq. 540-543. Shih edhe AYE, 1927, A/20/b, nr. pr. 13078, Administrata e Përgjithshme e Epirit për Ministrinë e Jashtme, Janinë 30-9-1927.

⁶⁷ Dokumente për Çamërinë, nr. 261, fq. 495-501.

⁶⁸ Si më lart, nr. 274, fq. 520.

300 familjet kishin mbetur 70-80 dhe në Paramithi nga 600 familje kishin mbetur 400. I njëjti fenomen vihej re edhe në fshatra të tjerë të Thesprotisë. Pra, çamët privoheshin në thelb nga e drejta e përfaqësimit politik në këshillat komunalë dhe nuk morën pjesë në zgjedhjet lokale që u zhvilluan në tetor 1925, ashtu si qytetarët e tjerë grekë⁶⁹. Pala shqiptare artikulonte gjithashtu akuza duke pretenduar një trajtim diskriminues në dëm të tyre në ushtrinë greke, ku ata përdorshin ekskluzivisht në ndërtim rrugësh⁷⁰.

Të gjitha akuzave të mësipërme, pala greke u kundërvihej me argumentet e saj: së pari, ashtu siç kishte sqaruar shumë herë në të kaluarën, masat për shpronësim kishin karakter të përgjithshëm dhe u zbatuan me të njëjtën mënyrë për të gjithë nënshtetasit grekë. Akuzës se çamët diskriminoheshin edhe për sa u përket pronave të tyre, pala greke i kundërvinte argumentin se ata jo vetëm nuk ishin diskriminuar, por ishte treguar dhe kujdes i veçantë për një trajtim më të butë të tyre dhe për vendosje të një numri të kufizuar refugjatësh në Epir. Fillimisht, vendimet respektive të Ministrisë së Shëndetësisë të dt. 20 shtator dhe 1 tetor 1922, përcaktonin përdorimin e gjysmës së numrit të banesave dhe të çifligjeve të myslimanëve për refugjatët, por më vonë, me një vendim të dt. 20 nëntor të po atij viti, u urdhërua anulimi i zbatimit të masave të mësipërme në nënprefekturat e Filatit, të Margaritit dhe të Paramithisë. Njëkohësisht, iu dhanë udhëzime zëvendësprefektëve të këtyre prefekturave që të merreshin vesh me myftinjtë, në mënyrë që vetë myslimanët të deklarorin se sa ndërtesa mund të ofronte çdo komunë⁷¹. Kështu për shembull, në qytetin e Pargës ishin përdorur për strehimin e refugjatëve vetëm 70 banesa, në Paramithi vetëm 10 dhe në rajonin e Filatit 10, të gjitha me aprovimin edhe të pronarëve. Në pranverën e vitit 1926, qeveria vendosi gjithashtu që të transferonte në Thesali dhe në Peloponez rreth 18.000 refugjatë që ishin vendosur

⁶⁹ Dokumente për Çamërinë, nr. 290, fq. 540-543.

⁷⁰ AYE, 1928, A/4/I, nr. pr. 4046, Kokotakis për Ministrinë e Jashtme, Tiranë 31-3-1928. Shih edhe Dokumente për Çamërinë, Nr. 294, fq. 555-560.

⁷¹ Ministria e Jashtme, 1919-1940. Dokumente Diplomatike Greke, Dh. Vizvizi-Dhonta, vëll. C, nr. 470, fq. 524-525.

një vit më parë në fshatra ku banonin dhe çamë, gjë që qeveria e atëhershme e Theodoros Pangalos i kishte premtuar palës shqiptare. Ndërkohë, duket se qeveria greke kishte patur presione për largimin e refugjatëve edhe nga kryetari i Komisionit të Trajtimit të Refugjatëve Kambel, i cili ishte i mendimit se nuk duheshin shpronësuar prona të vogla shqiptare për t'u vendosur refugjatët. Por kjo për vetë Kambelin nuk do të thoshte se «do të lejojmë çifligarët çamë të kenë një trajtim të ndryshëm nga pjesa tjetër e popullit grek»⁷². Ndryshimet politike që pasuan rënien nga pushteti të Pangalos, ndërprejnë këtë procedurë. Gjithsesi, sipas regjistrimit të popullsisë së vitit 1928, në të gjithë Epirin banonin gjithsej 8.179 refugjatë, nga të cilët 323 në rajonin e Paramithisë, 720 në rajonin e Filatit dhe 275 në rajonin e Margaritit. Sigurisht që këto shifra nuk mund të flisnin në favor të akuzave të palës shqiptare për trajtim të favorizuar të refugjatëve në dëm të shqiptarëve⁷³.

Ndërkohë, një pamje tjetër paraqisnin procedurat për kthimin të shpronësuarit të pronave që u takonin, pas përjashtimit të tyre nga shkëmbimi. Ngadalësia me të cilën avanconte zgjidhja e çështjeve respektive, të cilën e kishin marrë përsipër Komisioni i Shpronësimeve të Ministrisë e Bujqësisë dhe Shërbimi Emigrator, bëri që shumë çështje të mbeteshin pezull për një kohë të gjatë, veçanërisht në rajonin e Paramithisë. Si rezultat i këtyre vonesave, Banka e Greqisë, që monitoronte pronat bujqësore në proces shpronësimi, e kishte të pamundur, pa një vendim përfundimtar të Ministrisë, që t'u kthente pronat atyre që u takonin dhe njëkohësisht, t'u vendoste atyre qira, të cilën të interesuarit e kishin të pamundur ta paguanin për shkak të vështirësive ekonomike, dhe ankesat e tyre ishin të drejta. Në veçanti, për sa u përket rasteve të fshatrave Gardhiki dhe Dragumi, pas nënshkrimit të Marrëveshjes për Shkëmbim të Popullsive më 1923, banorët çamë të tyre (pothuaj 800 persona, në bazë

⁷² Divani, Greqia dhe minoritetet, fq. 237.

⁷³ Shërbimi i Përgjithshëm Statistikor i Greqisë, Rezultate statistikore të regjistrimit të popullsisë së Greqisë të dt 15 -16 Maj 1928. Vëll. I. Popullsia faktike dhe legale-Refugjatë.

të vlerësimeve të Komisionit Miks dhe të Ambasadës Shqiptare në Athinë), kishin shprehur në mënyrë masive dëshirën që të emigronin, si turq. Shumë prej tyre nënshkruan kontrata shitblerjeje të pronave të tyre me refugjatët, ndërsa të tjerë, pasi siguruan vërtetime për shpronësim të pronave të tyre, lejuan vendosjen e refugjatëve në pronat dhe banesat e tyre dhe u nisën për në Pargë, ku i prisnin anijet që do t'i transportonin për në Turqi. Kur masat e shkëmbimit për rastin e Çamëve u anuluan dhe ata filluan të ktheheshin në shtëpitë e tyre, fillimisht u përpoqën që të përfitonin nga ndryshimet që ndërkohë kishin ndodhur, duke qenë se refugjatët kishin kultivuar dhe i kishin kthyer në produktive mjaft toka dhe kishin riparuar mjaft banesa. Por më vonë filluan të protestojnë, duke kërkuar madje edhe anulimin e kontratave të shitblerjes që kishin nënshkruar si dhe kthimin e pronave të tyre⁷⁴. Më në fund, çështjen e mori në dorë Komisioni i Shpronësimeve, i cili mori përsipër që të shlyente rastet e diskutueshme dhe t'ua jepte tokën atyre që u takonte. Ndërsa në rastin e fshatit Dragumi ndarja u bë në mënyrë të tillë që të favorizonte jo vetëm refugjatët (pothuaj dhjetë familje) që ishin vendosur në fshat por edhe myslimanët pa tokë ose pronarë të vegjël, në rastin e Gardhikut procedurat e Komisionit u vonuan për një kohë të gjatë për shkak të pengesave ligjore që rridhnin nga statusi i shpronësimeve. Si rezultat i këtyre vonesave, pothuajse e gjithë procedura e rivendikimeve kishte mbetur pezull, gjendja ekonomike e banorëve, si e myslimanëve ashtu edhe e pothuajse 70 familjeve të refugjatëve që ishin vendosur në fshat, ishte tejet e vështirë dhe ankesat e tyre në vija të përgjithshme

74 AYE, 1927, A/20/b, nr. pr. 13078, Administrata e Përgjithshme e Epirit për Ministrinë e Jashtme, Janinë 30-9-1927. Tregues i ndërhyrjes shqiptare dhe i përpjekjeve të saj që çamët të ndryshonin mendimin e shprehur më parë, është fakti se vetëm një muaj para vendimit përfundimtar për përjashtimin e tyre nga shkëmbimi, në janar të vitit 1926, Ambasada Shqiptare në Athinë, në një letër të saj drejtuar Qenan Mesares, konstaton se “duhet të bindim banorët e Gardhikut dhe të Dragumit, se vetëm duke rivendikuar pronat e tyre si shqiptarë, do të shpëtojnë prej vuajtjeve të tyre”. Dokumente për Çamërinë, nr. 260, fq. 493-494.

ishin të drejta⁷⁵. Çështja e Gardhikit u zgjidh përfundimisht vetëm në dhjetëvjeçarin e 1930-ës, kur me interesimin e Prefekturës së Paramithisë u bë zhbllokimi i pronave të myslimanëve dhe me mënyra të tjera u dëmshpërblyen familjet e refugjatëve, por pa i larguar nga zona.

Për sa i përket çështjes së zgjedhjes së këshillave komunalë, sipas qëndrimit zyrtar grek, mospjesëmarrja e çamëve në to i dedikohet faktit se në vitin 1925, çështja e shkëmbimit të tyre qëndronte akoma pezull. Që nga momenti që ishte marrë vendimi përfundimtar për përjashtimin e tyre nga shkëmbimi, kishin filluar të zhvilloheshin edhe zgjedhjet e pjesshme vendore. Së fundmi, pala greke hidhte poshtë akuzat e palës shqiptare që bënin fjalë për keqtrajtim të ushtarëve me origjinë shqiptare, duke sjellë si argument faktin se në ushtrinë greke nuk kishte diskriminim⁷⁶. Ekzistonin ndërkohë indicie se veçanërisht në këtë çështje të fundit, akuzat shqiptare nuk ishin të pabaza⁷⁷. Sidoqoftë, ashtu siç mund të konstatojë çdokush, si nga burimet e disponueshme greke ashtu dhe nga ato shqiptare që janë botuar, ekzistonte një konfuzion i përgjithshëm dhe kishte shumë kundërthënie për sa i përket funksionimit të institucioneve greke dhe trajtimit të çamëve nga ana e tyre. Kështu për shembull, ndërkohë që Ministria e Punëve të Brendshme, me një vendim të saj të vitit 1925, i përjashtoi çamët nga pjesëmarrja në zgjedhjet vendore, me argumentin se procedura e shkëmbimit qëndronte ende pezull, Ministria e Luftës, përkundrazi, më një vendim të shtatorit të vitit 1927, thirri çamët që e kishin kaluar ndërkohë moshën e rekrutimit, të shërbenin në ushtrinë greke, përderisa çështja e shkëmbimit

⁷⁵ AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 6527, Nënkomanda e Xhandarmërisë Paramithi-Margariti për Ministrinë e Jashtme, Paramithi 25-5-1928.

⁷⁶ AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 3010, Administrata e Përgjithshme e Epirit për Ministrinë e Jashtme, Janinë 8-3-1928.

⁷⁷ Mihalopoulos, Çamët, fq. 119, shën. 75. Ka ndërkohë informacione se diskriminime kishte edhe për rekrutët sllavishtfolës të Maqedonisë Perëndimore, të cilët trajtoheshin atë periudhë si ushtarë të kategorisë së dytë. Për ta, pengesa gjuhësore dhe vështirësitë që rridhnin prej saj, ishin arsyet kryesore që i bënin dezertorë. Lidhur me këtë, shih T. Kostopoulos, Gjuha e ndaluar. Shtypje shtetërore të dialekteve sllave në Maqedoninë greke, Athinë 2000, fq. 138, shën. 84.

të tyre ishte me vendim të qeverisë greke në 1923 dhe ata mbetën në vend si qytetarë grekë me origjinë shqiptare⁷⁸.

Këtë konfuzion të përgjithshëm të institucioneve greke e bënte më të theksuar shfrytëzimi i qëllimshëm që shumë prej çamëve i bënë problem të shtetësisë së dyfishtë. Në bazë të mundësive që u akordonte neni 4 i Traktatit të Athinës, që ishte nënshkruar midis Greqisë dhe Perandorisë Otomane më 14 nëntor 1913, mjaft prej myslimanëve të Çamërisë – pothuaj 600 familje – kishin zgjedhur nënshtetësinë otomane në vend të asaj greke, me perspektivën që të largoheshin për në Turqi, gjë që nuk u bë e mundur të realizohej, përveç pak rasteve, për shkak të përplasjeve ushtarake që pasuan. Në vazhdim, ata e morën mbrapsht vendimin e mëparshëm dhe u bënë qytetarë Grekë, duke siguruar në këtë mënyrë pronat e tyre në Epir. Në vitin 1923, kur u shtrua çështja e shkëmbimit të popullsisë, shumë prej tyre, duke iu referuar vendimit të tyre të parë, kërkuan dhe më në fund e morën lejen për të emigruar në Turqi. Argumentit grek se ky vendim përbënte një shprehje të qartë të ndërgjegjes së tyre turke, rrjedhimisht, të gjithë myslimanët e kësaj kategorie duhej të shkëmbeheshin, pala shqiptare përgjigjej se në vitin 1913, kur shumica e çamëve bënë kërkesë për marrjen e nënshtetësisë turke, akoma nuk ishte njohur dhe përcaktuar qartë pozita ndërkombëtare e Shqipërisë, rrjedhimisht ata nuk kishin shumë mundësi zgjedhjeje⁷⁹. Të gjithë ata myslimanë që mbetën përfundimisht në rajonin e Çamërisë, kishin tashmë mundësinë të paraqiteshin me dy identitete, në varësi të faktit se cila prej këtyre të dyjave u interesonte për momentin: herë paraqiteshin si nënshtetas otomanë, me qëllim që t'i shmangeshin mobilizimit në ushtrinë greke, dhe herë si qytetarë grekë me origjinë

⁷⁸ Shih konstatime analoge të Administratës së Përgjithshme të Epirit në AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 3010, Administrata e Përgjithshme e Epirit për Ministrinë e Jashtme, Janinë 8-3-1928. Shih edhe Dokumente për Çamërinë, nr. 294, fq. 555-560.

⁷⁹ AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 3238, Kokotakis për Mihalakopoulos, Tiranë 8-3-1928.

shqiptare, që përndiqeshin vazhdimisht prej autoriteteve greke⁸⁰. Në këtë mënyrë, sipas shifrave të vitit 1928 dhe siç rezulton nga arkivi i zyrës së mobilizimit ushtarak të Janinës, nga ata që kishin zgjedhur në fillim shtetësinë otomane, pothuaj 70 persona ishin mobilizuar kohë pas kohe në ushtrinë greke dhe në vazhdim ishin liruar pasi kishin paraqitur fakte se ishin nënshtetas otomanë, ndërsa pothuajse 90 të tjerë kërkoheshin prej autoriteteve si rekrutë që nuk ishin paraqitur⁸¹.

Në lidhje me çështjen e arsimit, qeveria shqiptare kërkonte hapjen e dy ose tre shkollave për shqiptarët e Çamërisë⁸², ndërkohë që vetë ajo mbante rreth 65 shkolla për minoritetin grek që jetonte në shtetin shqiptar. Pala greke ishte kategorikisht kundër që çështja e hapjes së shkollave myslimane për shqiptarët, të lidhej me çfarëdolloj mënyrë me vazhdimin e funksionimit të shkollave minoritare greke. Madje e konsideronte të gjithë këtë çështje si një gjetje ekskluzive të propagandës shqiptare, përderisa asnjëherë deri në atë moment nuk kishin funksionuar në rajon shkolla shqiptare, madje as në periudhën e Perandorisë Otomane⁸³. Pala greke konsideronte ndërkohë se kërkesa që ishte paraqitur nga përfaqësues të komunave të Paramithisë, të Karbunarës dhe të Filatit, për hapjen e dy shkollave myslimane dhe një shkolle për vajza, duke marrë përsipër që shpenzimet të përballoheshin nga vetë këto komuna, ishte rezultat i drejtpërdrejtë i propagandës shqiptare⁸⁴. Ajo nga e cila kishte kryesisht frikë qeveria greke, ishte se këto shkolla myslimane do të shndërroheshin

⁸⁰ AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 3010, Administrata e Përgjithshme e Epirit për Ministrinë e Jashtme, Janinë 8-3-1928. Shih dhe Société des Nations, C. 575. 1927. I, Protection des minorités en Grèce, Genève 22-11-1927.

⁸¹ AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 4779, Seksioni politik B' për Seksionin Politik A' të Ministrisë së Jashtme, Athinë 24-4-1928.

⁸² AYE, 1927, A/20/b, nr. pr. 13218, Mihalakopoulos për Ministrinë e Jashtme, Paris 1-10-1927.

⁸³ AYE, Tetor 1927-1928, A/4/I, nr. pr. 207, Ministria e Jashtme për Ambasadën në Tiranë, Athinë 11-1-1928.

⁸⁴ Nuk ishte i rastit fakti që kërkesa respektive drejtuar Inspektoriatit të Shkollave Filllore për ngritjen e një shkolle fetare për vajza, e bëri Musa Demi, duke nënshkruar si kryetar i komunitetit mysliman të Filatit. AYE, 1927, A/20/b, nr. pr. 10416, Ministria e Jashtme për Administratën e Përgjithshme të Epirit, Athinë 19-11-1927, bashkëngjitur nr. 44.

në qendra antigreke mësimi dhe ndikimi mbi shqiptarët e Epirit⁸⁵. Pikërisht një zhvillim të tillë të mundshëm, shteti grek dëshironte ta pengonte me çdo mënyrë. Ndjekja e shkollave greke prej brezit të ri të çamëve ishte mjeti parësor për integrimin gradual të tyre në shoqërinë dhe në shtetin grek, për edukimin e tyre me moralin e shoqërisë greke dhe mundësisht, helenizimin e tyre gjuhësor. Vetëm në këtë mënyrë, ata në një periudhë afatgjatë, nuk do t'u përgjigjeshin më thirrjeve të qeverisë shqiptare, e cila me këmbëngulje vazhdonte t'i rivendikonte.

Për të qenë realistë duhet thënë se gjendja arsimore në rajonin e Çamërisë ishte pothuajse e pakontrolluar. Ndjekja e shkolla fillore publike prej fëmijëve të myslimanëve nuk ishte e detyrueshme, siç ndodhte me fëmijët e të krishterëve, por ndërkohë, edhe vetë prindërit myslimanë, për arsye fetare, nuk pranonin mësues të krishterë grekë. Madje nuk pranonin që nëpër shkolla të mësonin së bashku djem dhe vajza, edhe kur ata ende nuk kishin mbushur 10 vjeç. Megjithëkëtë, Administrata e Përgjithshme e Epirit u kishte rekomanduar mësuesve që të përpiqeshin për të tërhequr fëmijët e çamëve nëpër shkolla. Madje, për t'i bërë ata që të ndiqnin shkollën, shteti grek kishte emëruar mësues myslimanë për të dhënë lëndën e fesë dhe të gjuhës arabe nëpër komunitete me popullsi mikse. Më konkretisht, në vitin 1928 ishin emëruar dy mësues myslimanë për rajonin e Paramithisë dhe tetë për rajonin e Filatit⁸⁶. Por fëmijët myslimanë, në vija të përgjithshme, nuk i ndiqnin shkollat fillore publike greke: Në Mazarakia p.sh., përmendet se nga 50-60 fëmijët e komunitetit, ndiqnin shkollën vetëm 5 – 10 prej tyre. Preferonin të ndiqnin shkolla jo zyrtare myslimane ku klerikët myslimanë u jepnin mësimet fetare, u mësonin gjuhën arabe dhe pak shqip. Ministria e Jashtme Greke ishte e mendimit se nuk duhej t'i nxirrnin pengesa këtij arsimimi klandestin prej klerikëve, sepse në fund të fundit përbënte një avantazh të dyfishtë: nga njëra anë mund të ndalohej

⁸⁵ AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 6527, Nënkomanda e Xhandarmërisë Paramithi-Margariti për Ministrinë e Jashtme, Paramithi 25-5-1928.

⁸⁶ AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 3010, Administrata e Përgjithshme e Epirit për Ministrinë e Jashtme, Janinë 8-3-1928.

në çdo moment si arsimim i jashtëligjshëm dhe nga ana tjetër mund të përdorej si kundërpërgjigje ndaj kërkesave të palës shqiptare për hapje shkollash të reja. Por një pikëpamje diametralisht të kundërt kishte me sa duket, Administrata e Përgjithshme e Epirit, e cila kishte nxjerrë një urdhëresë për nënkomandat e xhandarmërisë për anulimin, mundësisht me sa më pak zhurmë, të funksionimit të këtyre shkollave informale. Urdhrin e Administratës së Përgjithshme e anuloi me një vendim të saj Ministria e Punëve të Jashtme⁸⁷, por u tërhoqi vëmendjen autoriteteve lokale që të mos lejonin funksionimin e më tepër shkollave se ato që ekzistonin jo zyrtarisht, kryesisht në ato komunitete ku shteti grek kishte emëruar mësues myslimanë. Paralelisht, mësuesit grekë duhej të vazhdonin përpjekjet për tërheqjen e fëmijëve të myslimanëve në shkollat fillore shtetërore⁸⁸. Për fat të keq nuk disponojmë të dhëna analitike në lidhje me numrin e këtyre shkollave që funksiononin ilegalisht. Për vitin 1928 përmendet funksionimi i këtyre shkollave në komunat Varfani, Grekohori, Suvlasi dhe Spatari, por numri i tyre sigurisht që ishte më i madh⁸⁹.

Gjithsesi ajo që duhet theksuar, duke bërë një bashkëvlerësim edhe të të dhënave që disponojnë burimet shqiptare, është se boshti kryesor i kërkesave dhe ankesave shqiptare kundër autoriteteve greke, përbëhej kryesisht prej çështjeve ekonomike dhe pronësore. Referencat për çështje arsimore zinin në më të shumtën e rasteve, pozicionet më të ulëta në listat e protestave apo dhe të rivendikimeve respektive të palës shqiptare. Po këtë përshtypje krijon lexuesi nëse studion demarshet respektive shqiptare në Lidhjen e Kombeve, të cilat ishin shumë të shpeshta gjatë gjithë periudhës që nga fillimi i vitit 1927 deri në mes të vitit pasardhës, një periudhë që siç e përmendëm, karakterizohej nga reagimet e ashpra të qeverisë shqiptare kundërshtimit të palës greke për të ratifikuar njërën prej marrëveshjeve që ishin nënshkruar në vitin 1926.

⁸⁷ AYE, 1927, A/20/b, nr. pr. 15190, Administrata e Përgjithshme e Epirit për Min. e Jashtme, Janinë 15-11-1927.

⁸⁸ AYE, 1927, A/20/b, nr. pr. 14834, Min. e Jashtme për Administratën e Përgjithshme të Epirit, Athinë 17-11-1927.

⁸⁹ AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 6527, Nënprefektura e Paramithisë-Margaritit për Min. e Jashtme, Paramithi 25-5-1928.

Pra, mund të themi, se rreth këtyre dy çështjeve madhore u zhvillua kryesisht veprimtaria propagandistike shqiptare, sidomos në gjysmën e dytë të dhjetëvjeçarit 1920. Që prej fillimit të vitit 1927, shtypi shqiptar filloi një fushatë të vërtetë antigreke, me një shumicë shkrimesh që nuk kufizoheshin vetëm në referime për keqtrajtim të çamëve nga ana e shtetit grek dhe për shkelje të të drejtave të tyre, por drejtohej edhe kundër minoritetit grek që jetonte në Shqipëri, duke ndërsyer nacionalizmin shqiptar kundër këtij minoriteti. Në mënyrë veçanërisht të theksuar madje, përsëritej pretendimi se çamët, për shkak të presioneve të padurueshme që ushtronte mbi ta Greqia, kishin filluar tashmë të kërkonin një strehë në Shqipëri. Shtypi shqiptar bënte insinuata të qarta se një lëvizje e tillë do të zhvillohej në dëm të elementit grek në Shqipëri, dhe si përfundim, gjendja e krijuar do të rezultonte në një shkëmbim popullsish⁹⁰. Sigurisht që ishte një kërcënim i cili ishte formuluar edhe në të kaluarën nga ana e palës shqiptare si mjet presioni ndaj Greqisë, me qëllim që ajo të përshpejtonte ritmet për kompensimin e pronave shqiptare. Bile, sipas ambasadorit shqiptar në Athinë Stavro Stavri, këto shkrime në shtypin shqiptar ishin shumë të vlefshme dhe përbënin një përgjigje për artikujt respektivë të gazetave greke, të cilat vazhdimisht ankoheshin për kushtet e jetesës së “grekofonëve” të Shqipërisë dhe shkeljen e të drejtave të tyre arsimore⁹¹.

Paralelisht me fushatën që kishte shpërthyer në shtyp, u zhvillua dhe një veprimtari e theksuar propagandistike edhe brenda në Epir, me protagonistë Masar Dinon⁹², Azis Agan, Husein Iljaz Lukaviciotin, Musa Demin etj. Po këta persona do të luanin rolin e protagonistit edhe më vonë, si liderë të myslimanëve të Çamërisë, gjatë lëvizjeve për autonomi që do të shfaqeshin në periudhën e Luftës së Dytë Botërore. Një tregues i qartë se këto lëvizje ishin të orientuara, është edhe fakti se, siç rezultojnë prej të dhënave të palës

⁹⁰ AYE, 1927, A/20/b, Memorandum sekret i Seksionit A' Politik i Ministrisë së Jashtme, Athinë 22-10-1927.

⁹¹ Dokumente për Çamërinë, nr. 282, fq. 527-528

⁹² Gjatë pushtimit italian të Epirit në Luftën e Parë Botërore, Masar Dino kishte shërbyer si nënkomandant i Paramithisë. AYE, 1927, A/20/b, nr. pr. 13078, Administrata e Përgjithshme e Epirit për Ministrinë e Jashtme, Janinë 30-9-1927.

shqiptare, këta persona dhe mjaft të tjerë, kishin në po atë periudhë por edhe më vonë, kontakte të rregullta me ambasadën shqiptare në Athinë, nga ku merrnin udhëzime si dhe favore të çdo lloji⁹³. Domethënës është rasti i Masar Dinos, i cili paraqitet si “përfaqësues i Çamërisë”. Në muajin prill të vitit 1930, si Masari ashtu dhe i vëllai Nuri Dino, i cili gjendej në Tiranë, i drejtuan thirrje Ministrisë së Jashtme Shqiptare për akordim ndihme ekonomike. Sipas letrës së Nuriut, Masari ishte në gjendje të keqe ekonomike për shkak të masave të frikësimit që viteve të fundit ushtronin kundër tij autoritetet greke, pasi e konsideronin si nxitës të protestave drejtuar Lidhjes së Kombeve dhe të ankesave të ndryshme që parashtronin herë pas herë çamët, dhe si rezultat i këtyre, Masari nuk kishte as mjetet e nevojshme për të mbrojtur familjen e tij. Rrjedhimisht, pa mbështetjen morale dhe materiale të Shqipërisë, shkruante Nuriu, Masari do ta kishte të pamundur të vazhdonte të jetonte në Çamëri, sepse “një njeri pa asnjë mjet nuk mund të përballej me një shtet dhe do të detyrohej t’i linte çamët në fatin e tyre”⁹⁴. Në përgjigjen që u dha këtyre letrave, ministri i Jashtëm shqiptar Rauf Fico, fillimisht shprehte falënderimet e tij për Masar Dinon dhe se i njihte shërbimet e tij të çmuara për mbrojtjen e të drejtave të bashkëpatriotëve të tij, dhe në vazhdim, meqenëse gjykonte se qëndrimi i tij në Çamëri ishte i domosdoshëm, i premtonte se do t’i akordonte mbështetjen e nevojshme morale dhe materiale⁹⁵.

Gjithashtu, me nxitjen e propagandës shqiptare, banorë të komunave të ndryshme si të Gardhikit, të Dragumisë, të Filatit, të Pargës etj. i drejtuan letra të njëpasnjëshme proteste Lidhjes së Kombeve, gjatë gjithë vitit 1927 dhe në fillim të vitit 1928, me akuzat e njohura për keqtrajtim të tyre nga autoritetet greke dhe shkelje të të drejtave pronësore⁹⁶. Qeveria

⁹³ Dokumente për Çamërinë, nr. 276-284, fq. 521-529.

⁹⁴ Po aty nr. 307-308, fq. 602-604.

⁹⁵ Po aty, nr. 309, fq. 605.

⁹⁶ AYE, 1927, A/20/b, nr. pr. 13078, Administrata e Përgjithshme e Epirit për Ministrinë e Jashtme, Janinë 30-9-1927. Akuzat kryesore që formuloheshin, kishin të bënin me shpronësimet e detyrueshme të pronave të tyre në favor të refugjatëve, kishin të bënin me faktin se nuk kishin akses në zgjedhjen e pushtetit vendor si dhe me faktin se në Çamëri nuk funksiononte asnjë shkollë shqipe.

shqiptare nga ana e saj, kujdesej që t'i mbështeste këto protesta me demarshe respektive, si në drejtim të Sekretarit të Përgjithshëm të Lidhjes ashtu edhe të qeverive të vendeve europiane, veçanërisht të Anglisë, Francës dhe Italisë. Pala greke iu përgjigjej menjëherë dhe në mënyrë analitike akuzave shqiptare, duke dhënë sqarime për të gjitha akuzat, sqarime që në vija të përgjithshme pranoheshin prej Lidhjes së Kombeve⁹⁷.

Por ajo që me sa duket shqetësonte autoritetet greke në atë periudhë, ishte gjetja e atyre shkaqeve që jo vetëm lejonin, por në vija të përgjithshme e bënë edhe rezultate propagandën shqiptare në Epir. Fillimisht, vetë popullsitë myslimane, ashtu siç i përshkruanin autoritetet lokale, ishin njerëz të thjeshtë, me nivel të ulët kulturor dhe për shkak të fesë së tyre, ishin asimiluar pak prej pjesës tjetër të popullsisë. Jetonin pothuajse të izoluar, të përndjekur prej ligjeve të pashkruara të gjakmarrjes dhe e kishin zakon të konsideronin si liderë të tyre, përfaqësuesit e parisë së rajoneve, të cilët zakonisht ishin më të kamurit ekonomikisht, dhe njerëzit e thjeshtë u bindeshin⁹⁸. Pozita e grave përcaktohej rreptësisht prej ligjeve, zakoneve dhe traditave islame, ndërsa prania e një ndarjeje të veçantë në shtëpi vetëm për gratë dhe qarkullimi i tyre në ambiente publike vetëm me ferexhe, ekzistonte akoma edhe në fund të viteve '30⁹⁹. Këto karakteristika bënë që t'i pranonin në një masë të madhe mesazhet që u vinin nga propaganda shqiptare, e cila i mashtronte këta njerëz. Por, në një rrafsh më të përgjithshëm, gjendja e rënduar ekonomike që mbizotëronte në Epir në atë periudhë, mosveprimi dhe mungesa e eficientë që vihej re në administratën e shtetit grek, krijonin kushte të favorshme për zhvillimin dhe përhapjen e çdo lloj veprimtarie subversive. Popullsia e rajonit, si ajo

⁹⁷ Në mënyrë analitike për përmbajtjen e notave të shqiptarëve në Lidhjen e Kombeve, për përgjigjet e Greqisë dhe për vendimet e Këshillit, shih Mihalopoulos, Çamët, fq. 122-134, dhe Divani, Greqia dhe minoritetet, fq. 238-242.

⁹⁸ AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 3010, Administrata e Përgjithshme e Epirit për Ministrinë e Jashtme, Janinë 8-3-1928.

⁹⁹ AYE, 1939, A/4/9-10, nr. pr. 27907, Administrata e Përgjithshme e Epirit për Ministrinë e Jashtme, Janinë 18-11-1938, Raport i bashkëngjitur i Komandës së Xhandarmërisë së Thesprotisë.

e krishterë ashtu dhe ajo myslimane, vuante pasojat e gjendjes së rëndë ekonomike, rrjeti rrugor i komunikacionit në Epir ishte pothuajse inekzistent, shërbimi telegrafik dhe telefonik ishte difektoz, shërbimi shëndetësor ishte fare i pazhvilluar, dhe në të njëjtën kohë grabitjet dhe plaçkitjet vazhdonin të ishin një torturë e vërtetë për zonat rurale, duke krijuar një ndjenjë pasigurie të përgjithshme te banorët¹⁰⁰. Veçanërisht në rajonet e Paramithisë dhe të Margaritit konstatohej një mungesë edhe më e madhe e shërbimeve administrative për shkak të suprimimit të dy nënprefekturave dhe transferimit të autoriteteve të Margaritit në Parga¹⁰¹. Për më tepër, forcat e xhandarmërisë të stacionuara në Paramithi dhe në Margariti, as nuk i mbulonin nevojat dhe as nuk ishin në gjendje të frymëzonin besimin tek popullsia e atyre zonave, përderisa jo vetëm rajonet e xhandarmërisë ishin të pamjaftueshme por edhe për faktin se shumica e xhandarëve që shërbenin atje ishin të mobilizuar nga fshatrat përreth, kishin marrëdhënie personale me banorët, të krishterë apo myslimanë, dhe shpesh u shmangeshin apo neglizhonin detyrat e tyre.

Siç vinin në dukje veçanërisht autoritetet lokale, por edhe siç po kuptohej edhe nga instanca më të larta, nuk mund të lejohej që gjendja të vazhdonte ashtu siç ishte, duke e lënë pre popullsinë myslimane në duart e propagandës së huaj, e cila shfrytëzonte me sukses dobësitë ekzistuese. Urgjentisht duhej të merreshin masa që kishin të bënin kryesisht me zhvillimin e infrastrukturës në rajon dhe forcimin e administratës. Ajo që dilte si përparësi, ishte përmirësimi i rrjetit të komunikacionit, ndërtimi i rrjetit kombëtar dhe lokal të rrugëve dhe urave, në mënyrë që të vendosej komunikimi me rajonet fqinje. Dilte si detyrë edhe përmirësimi i telekomunikimeve. Një kujdes i veçantë i duhej kushtuar gjithashtu fuqizimit të administratës qendrore, duke punësuar në të kuadro të përgatitur dhe me një mision të përcaktuar qartë, si dhe fuqizimi i trupës së

¹⁰⁰ AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 6527, Nën-Administrata Paramithi-Margariti për Min. e Jashtme, Paramithi 1-6-1928.

¹⁰¹ AYE, 1927, A/20/b, nr. pr. 13078, Administrata e Përgjithshme e Epirit për Ministrinë e Jashtme, Janinë 30-9-1927.

xhandarmërisë, në mënyrë që të luftohej efektivisht fenomeni i grabitjeve dhe vjedhjeve dhe të ndihej prezenca e shtetit në të gjithë rajonin. Dhe e fundit, autoritetet lokale propozuan fuqizimin e forcave të ruajtjes së kufirit, me qëllim që të kufizohej hyrja ilegale e shqiptarëve nga kufiri dhe të lehtësohej ndjekja e veprimtarisë së tyre në brendësi të vendit¹⁰².

Por përpara se të merrej çfarëdolloj vendimi për materializimin e këtyre propozimeve, filluan të shfaqeshin shenjat e para të një tensionimi të mëtejshëm të marrëdhënieve midis Athinës dhe Tiranës, një tensionim i cili sigurisht që ishte një ogur i keq për të ardhmen. Në këtë moment dhe për të shmangur një krisje sensacionale, do thoshim, të marrëdhëniet dypalëshe, doli përsëri në skenë një faktor i cili që nga ai moment dhe vazhdimisht në të ardhmen, do të luante një rol përcaktues në zhvillimet që njohu çështja e çamëve: bëhet fjalë sigurisht për diplomacinë italiane, e cila ndërmori përpjekje intensive ndërmjetësuese për çtensionimin e krizës greko-shqiptare.

Është i njohur interesimi që Italia ka treguar vazhdimisht për brigjet lindore të Adriatikut, një interesim i cili u demonstrua në mënyrë aktive që prej periudhës së bashkimit të saj në një shtet kombëtar dhe që arriti kulmin me operacionet luftarake që u zhvilluan gjatë Luftës së Parë Botërore¹⁰³. Roli i Italisë për krijimin e shtetit të pavarur shqiptar dhe ravijëzimin e kufijve të tij ishte parësor¹⁰⁴, ndërsa mbajtja e këtij shteti në sferën e saj të ndikimit, u sanksionua me nënshkrimin e Traktatit të Miqësisë dhe të Bashkëpunimit Reciprok midis dy vendeve në nëntor të vitit 1926, për t'u risanksionuar një vit më vonë me nënshkrimin e Traktatit të Aleancës dypalëshe¹⁰⁵. Shqipëria ishte veçanërisht e

¹⁰² AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 6527, Nën-Administrata Paramithi-Margariti për Min. e Jashtme, Paramithi 1-6-1928.

¹⁰³ Më shumë për politikën italiane gjatë kësaj periudhe shih B. Kondis, "The Northern Epirus Question during the First World War", *Balkan Studies* 30.2 (1989), 333-349, gjithashtu P. Pastorelli, *L'Albania nella politica estera italiana 1914-1920*, Napoli 1970 dhe A.G.Kartali, *Politika italiane në Shqipëri dhe Ballkan*, Athinë 1914.

¹⁰⁴ Më shumë për temën shih B. Kondis, *Greece and Albania 1908-1914*, Institute for Balkan Studies, Thessaloniki 1976. Gjithshtu, E. P. Stickney, *Southern Albania or Northern Epirus in European International Affairs 1912-1923*, Stanford 1926.

¹⁰⁵ Më shumë për marrëveshjet e 1926 dhe 1927, shih P. Pastorelli, *Italia e Albania, 1924-1927. Origini diplomatiche del Trattato di Tirana del 22 Novembre 1927*, Firenze 1967.

rëndësishme si urë për shtrirjen e ndikimit italian fillimisht në Ballkan dhe më vonë në rajonin më të gjerë të Lindjes, prandaj ishte e domosdoshme që ajo të fuqizohej dhe të mbështetej në mosmarrëveshjet që kishte me vendet fqinje, veçanërisht me Greqinë dhe Jugosllavinë. Në veçanti për sa i përket Greqisë, roli i faktorit italian ishte i dyfishtë. Ndikimi grek, kryesisht në pjesën jugore të Shqipërisë, përbënte një pengesë për realizimin e synimeve italiane. Kështu që përpjekjet për kufizimin e këtij ndikimi, kërkonin që nga njëra anë italianët të përkrahnin palën shqiptare kundrejt presioneve të herëpashershme të palës greke, dhe nga ana tjetër të krijonin një kundërpeshë për minoritetin grek, i cili nga ana e tij do të funksiononte si një levë presioni mbi palën greke¹⁰⁶. Prezenca e çamëve në Epir përbënte kundërbalancën ideale dhe në këtë pikë interesat italiane përputheshin plotësisht me ato shqiptare, ndërsa propaganda italiane vepronte në Epir paralelisht dhe duke përkrahur propagandën shqiptare¹⁰⁷. Por nga ana tjetër, diplomacisë italiane i interesonte, të paktën për atë periudhë, që të mos i shkëpuste plotësisht lidhjet me Greqinë, dhe as të shkaktonte një krisje të pariparueshme në marrëdhëniet Greqi-Shqipëri, sepse i frikësohej një aleance të mundshme të Greqisë me Jugosllavinë dhe krijimin e një boshti greko-jugosllav¹⁰⁸. Nën këtë prizëm duhen analizuar përpjekjet që bënin diplomatët italianë në periudha tensioni të dukshëm në marrëdhëniet greko-shqiptare, me qëllim që të ulëshin gjakrat dhe të ndërmerreshin nisma lëshimesh reciproke për trajtimin e problemeve dypalëshe.

Italia filloi ta demonstrojë aktivisht predispozicionin e saj për të ndërmjetësuar midis dy vendeve që në muajt e parë të vitit 1927, kur

¹⁰⁶ ASMAE, Albania 1926, 729/426, sf. II semestre, no.1915/734, Aloisi për Ministero Affari Esteri, Durrës 28-10-1926.

¹⁰⁷ AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 3010, Administrata e Përgjithshme e Epirit për Ministrinë e Jashtme, Janinë 8-3-1928.

¹⁰⁸ ASMAE, Albania 1927, 741/499, no. 743/188, Arlotta për Ministero Affari Esteri, Athinë 20-4-1927. Gjatë asaj periudhe marrëdhëniet e Italisë me Jugosllavinë kalonin një fazë tensionimi, që kishte të bënte kryesisht me konsolidimin e ndikimit italian në shtetin shqiptar, ashtu siç përvijohet pas nënshkrimit të Traktatit të Miqësisë së vitit 1926.

ishte e qartë se marrëdhëniet greko-shqiptare po shkonin drejt një pike kritike: zhgënjimet e njëpasnjëshme që po provonte Athina në përpjekjet e saj të vazhdueshme për të arritur anulimin e masave kufizuese që i imponoheshin gradualisht funksionimit të shkollave të minoritetit grek, si dhe intensifikimi i propagandës shqiptare që po zhvillohej si nëpërmjet Shtypit ashtu edhe brenda vetë Epirit, kishin krijuar një klimë pakënaqësie të thellë, gjë që vështirësonte trajtimin dhe zgjidhjen e çështjeve të tjera që kishin mbetur pezull¹⁰⁹. Duke iu përgjigjur rekomandimeve të përsëritura të ambasadorëve të tij në Athinë dhe në Durrës, Musolini ra dakord për nevojën e ndërmarrjes së një nisme ndërmjetësuese, me objektiv ekskluziv evitimin e krisjes mes dy vendeve, e cila eventualisht, dhe kësaj i frikësoheshin italianët, do ta hidhte Greqinë në prehërin e Jugosllavisë¹¹⁰. Objektiv kryesor i përpjekjeve të palës italiane do të ishte që të bindte qeverinë shqiptare që ta trajtonte me tone të ulëta dhe me urtësi çështjen e pronave të shpronësuar të Shqiptarëve të Çamërisë, dhe njëkohësisht t'u jepte fund notave të njëpasnjëshme drejtuar Lidhjes së Kombeve me ankesa kundër Greqisë, të cilat, ndërsa nga njëra anë nuk sillnin rezultatin e pritshëm, helmonin ndërkohë marrëdhëniet midis dy vendeve fqinje dhe kishin shkaktuar pakënaqësi të thellë te qeveria greke¹¹¹. Kishte gjithashtu si qëllim të arrinte rifillimin e funksionimit të shkollave të minoritetit grek, mjaft prej të cilave qeveria shqiptare i kishte mbyllur në mënyrë krejtësisht arbitrare vitin e mëparshëm shkollor, me shpresë se këto dëshmi praktike të vullnetit të mirë, do të njiheshin nga qeveria greke, e cila nga ana e saj do të tregohej më shumë tolerante për sa i përket trajtimit të çamëve dhe çështjes së kompensimit të të shpronësuarve¹¹².

¹⁰⁹ ASMAE, Albania 1927, 741/499, no. 1121, Sola për Ministero Affari Esteri, Durrës 15-4-1927.

¹¹⁰ ASMAE, Albania 1927, 741/499, no. 743/188, Musolini për Ambasadën e Athinës, Romë 25-4-1927.

¹¹¹ ASMAE, Albania 1927, 741/499, no. 2108, Sola për Ministero Affari Esteri, Durrës 3-9-1927.

¹¹² ASMAE, Grecia 1928, 1237/5113, no. 2902, Sola për Ministero Affari Esteri, Durrës 21-12-1927.

Por ndërkohë, taktika e lidhjes së dy çështjeve mes tyre dhe akordimit palës shqiptare diçka si shkëmbim, konsiderohej si krejtësisht e gabuar nga ana e qeverisë greke, e cila në asnjë rast nuk ishte e predispozuar që të përjashtonte shqiptarët nga zbatimi integral i ligjit agrar dhe t'u rezervonte atyre një farë trajtimi të favorizuar¹¹³.

Kundërshtimi i Athinës për kthesën që po tentonin të merrnin ngjarjet me nismën italiane për ndërmjetësim, u shfaq qartë edhe te mosgatishmëria e saj për të pranuar ardhjen në Athinë të një delegacioni zyrtar shqiptar, që kishte si qëllim të diskutonte çështje në lidhje me pronat dhe me të drejtat e çamëve, një propozim që e bëri i ngarkuari me punë i Greqisë në Durrës Kokotaki në fillim të vitit 1928 dhe për arsye të kuptueshme u pranua menjëherë nga pala shqiptare. Por duket se i gjithë ky incident lidhej me një “gafë” të vërtetë të diplomatit grek, siç e pranoi edhe vetë ai më vonë: i entuziazmuar nga premtimet që kishte marrë për hapjen dhe funksionimin sërish të mjaft prej shkollave greke që ishin mbyllur vitin paraardhës, bëri propozimin e mësipërm pa u konsultuar më parë me qeverinë e tij¹¹⁴. Vlen për t'u theksuar se as pala italiane nuk ishte dakord me dërgimin e menjëhershëm të një delegacioni shqiptar në Athinë, në momentin që pikëpamjet e të dyja vendeve në lidhje me temat që diskutoheshin i ndante një hendek kaq i thellë. Në mënyrë që një nismë e tillë të kishte sukses, do të duhej një përgatitje serioze paraprake, me qëllim që të piqeshin kushtet dhe të arrihej njëfarë afrimi pikëpamjesh midis dy palëve, para se delegacioni shqiptar të vizitonte Greqinë¹¹⁵. Gjithsesi, ideja për dërgimin në Greqi të një komisioni të posaçëm që do të diskutonte çështjen e pronave, nuk ishte diçka e re për qeverinë shqiptare. Që në qershor të vitit 1925 ishte zhvilluar në Parlamentin shqiptar një diskutim

¹¹³ AYE, Tetor 1927-1928, A/4/I, nr. pr. 232, Ambasada e Romës për Ministrinë e Jashtme, Romë 30-12-1927.

¹¹⁴ ASMAE, Albania 1928, 756/589, no. 3324, Sola për Ministero Affari Esteri, Durrës 26-5-1928.

¹¹⁵ ASMAE, Grecia 1928, 1237/5110, no. 157, Sola për Ministero Affari Esteri, Durrës 7-1-1928.

me këtë temë dhe ishte miratuar propozimi për të dërguar në Athinë një delegacion parlamentar, gjë që nuk u realizua atëherë pasi grushti i shtetit i Pangallos në Greqi ndryshoi rrjedhën e ngjarjeve¹¹⁶. Ministria e Jashtme Greke u përpoq me çdo kusht që të dekurajonte vizitën, dhe si rrjedhojë në qarqet politike shqiptare u krijua një pakënaqësi e thellë. Në fund u vendos që të dërgoheshin në Athinë dy përfaqësues shqiptarë, Xhaferr Villa dhe Milto Tutulani, por jo me cilësinë e të dërguarve zyrtarë. Këta përfaqësues do ta shtronin çështjen për diskutim, por jo në negociata direkte me qeverinë greke, por nëpërmjet rrugës diplomatike, pra nëpërmjet Ambasadorit Shqiptar¹¹⁷. Natyrisht që rrethanat nën të cilat u bë propozimi dhe reagimet që pasuan, do t'i çonin apriori në dështim përpjekjet e misionit: dy të dërguarit shqiptarë nuk bënë gjë tjetër përveçse përsëritën pretendimet e njohura shqiptare në lidhje me mënyrën e shpronësimit dhe të kompensimit të pronave të nënshtetasve shqiptarë dhe kushtet e jetesës së çamëve të Epirit, për të marrë edhe një herë si përgjigje tezat e njohura greke mbi këto çështje. Rezultatet e kësaj vizite vërtetuan hendekun që tashmë ishte krijuar midis dy palëve, përderisa dy palët qëndronin fort në pozicionet e tyre dhe në horizont nuk dukej asnjë dëshirë për bashkëpunim. Në klimën e krijuar, qeveria shqiptare mori vendimin për t'iu drejtuar Lidhjes së Kombeve, me shpresën se kërkesat e saj për kompensim të pronave dhe trajtimin e çamëve nga ana e autoriteteve greke, do të konsideroheshin si të drejta.

Për këtë vendim të saj ajo informoi edhe qeverinë italiane, megjithëse në thelb nuk i thoshte ndonjë gjë të re: Presidenti i Republikës së Shqipërisë Ahmet Zogu kishte paralajmëruar ambasadorin italian në Durrës Ugo Sola që në dhjetor të vitit 1927, se nëse Greqia do të

¹¹⁶ AYE, 1925, G/62/5, nr. pr. 9579, Ambasada e Durrësit për Ministrinë e Jashtme, Durrës 3-7-1925, bashkëngjitur proces verbalet e diskutimit të 27 Qershorit në Parlamentin shqiptar për pronat shqiptare në Greqi. Shih dhe Dokumente për Çamërinë, nr. 237, fq. 438.

¹¹⁷ ASMAE, Albania 1928, 756/589, no. 380, Sola për Ministero Affari Esteri, Durrës 15-1-1928.

vazhdonte të ushtronte presion mbi çamët, atëherë Shqipëria do t'i drejtohej Lidhjes së Kombeve. Përgjigja që dha ambasadori Italian ishte se në një rast të tillë hipotetik, Shqipëria mund të shpresonte në mbështetjen italiane. Por në realitet, në atë periudhë diplomacia italiane ndodhej në një pozitë veçanërisht të vështirë: kontaktet greko-italiane për nënshkrimin e një traktati miqësie vazhdonin akoma, ndërkohë që në qarqet diplomatike italiane vazhdonte të qarkullonte ideja e nënshkrimit të një traktati trepalësh midis Italisë, Greqisë dhe Turqisë¹¹⁸. Një përkrahje e hapur e ankesës që po planifikonte pala shqiptare, sigurisht që do të rrezikonte planet ambicioze të Italisë për t'u shndërruar në një fuqi hegjemone në rajon. Për këtë arsye, përkrahja e nismës shqiptare nuk mund të ishte ndryshe, përveçse indirekte dhe e kujdesshme: ndërsa zyrtarisht pala italiane nuk dukej se merrte pjesë në marrjen e vendimit ose, se ishte dakord me nismën për t'iu drejtuar Lidhjes së Kombeve, në mënyrë jo zyrtare pranonte se pikëpamjet e palës shqiptare ishin të drejta dhe e konsideronte qëndrimin e palës greke si paradoksal dhe intransigjent¹¹⁹. Në vend të qëndrimeve të palës greke, pala italiane propozonte gjetjen e një zgjidhjeje kompromisi për çamët, e cila do të rezultonte nga negociatat direkte, një propozim me të cilin qeveria greke nuk ishte dakord pasi diçka e tillë do të thoshte njohjen indirekte të Shqipërisë si mbrojtëse të minoritetit shqiptar në Greqi¹²⁰. Siguritë që jepte Musolini se nuk kishte inkurajuar një nismë shqiptare në Lidhjen e Kombeve, nuk ishin të mjaftueshme për të bindur qeverinë greke, përderisa nuk kishte ndonjë mënyrë tjetër interpretimi, as për interesin e veçantë që tregonte pala italiane dhe këmbënguljen e saj në përkrahjen e qëndrimeve shqiptare, me gjithë sqarimet që i kishte dhënë herë pas here Greqia, dhe sigurisht as për vendosmërinë dhe

¹¹⁸ Më shumë për negociatat që zhvilloheshin në atë periudhë dhe për ekuilibrin e forcave në Ballkanin e jugut shih K. Karamanli, *Eleftherios Venizellos dhe marrëdhëniet tona me jashtë, 1928-1932*, Athinë 1986.

¹¹⁹ ASMAE, Grecia 1928, 1237/5113, no. 2902, Sola për Ministero Affari Esteri, Durrës 21-12-1927.

¹²⁰ AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 6339, Dhendhramis për Ministrinë e Jashtme, Gjenevë 3-6-1928.

këmbënguljen e qeverisë shqiptare në qëndrimet e saj antigreke¹²¹. Nga ana tjetër, perspektiva e një ankese të Shqipërisë në Lidhjen e Kombeve, nuk e shqetësonte shumë udhëheqjen politike greke, sepse kishte bindjen se mundësitë e pranimit të pikëpamjeve shqiptare ishin të pakta¹²². Siç kemi përmendur më lart, në të kaluarën Shqipëria kishte bërë në mënyrë të përsëritur demarshë me përmbajtje të ngjashme, të cilat në tërësinë e tyre ishin hedhur poshtë nga kjo Organizatë Ndërkombëtare dhe shpjegimet që kishte dhënë pala greke ishin konsideruar të mjaftueshme. Madje ndonjëri mund të mendojë se Greqia, deri në një farë mase “e kërkonte vetë” një diskutim të tillë në Lidhjen e Kombeve, në mënyrë që t’i jepej fund një herë e mirë këtij zinxhiri të pafund padish dhe kundërpadish.

Kështu, me gjithë përpjekjet italiane që çështja të mos arrinte në Këshillin e Lidhjes së Kombeve, pasi diçka e tillë do ta vinte në një pozitë veçanërisht të vështirë përfaqësuesin Italian¹²³, por të gjendej një zgjidhje kompromisi me lëshime të palës greke për sa i takon çështjes së pronave shqiptare¹²⁴, padia shqiptare u diskutua më në fund në Sesionin e 50-të të Këshillit, ditët e para të qershorit të vitit 1928. Përfaqësuesi shqiptar Mit’hat Frashëri përsëriti edhe një herë kërkesat e qeverisë shqiptare në lidhje me çështjen e pronave që ishin shpronësuar, duke propozuar bile ngritjen e një komisioni miks, i cili do të merrte përsipër zgjidhjen përfundimtare

¹²¹ AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 5268, Ministria e Jashtme për Ambasadën në Bernë, Athinë 14-5-1928.

¹²² Për hollësi në lidhje me pikpamjet greke dhe zhvillimet që i paraprinë ankesës shqiptare, shih Mihalopoulos, Çamët, fq. 137-148.

¹²³ Për shkak se ekzistonte Traktati italo-shqiptar i Miqësisë dhe i Bashkëpunimit Reciprok, përfaqësuesi Italian do të ishte i detyruar të mbështeste me argumente ligjorë padinë shqiptare para Këshillit të Lidhjes së Kombeve, gjë që sigurisht do ta vinte përballë me delegacionin grek. AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 6339, Dhendhramis për Ministrinë e Jashtme, Gjenevë 3-6-1928.

¹²⁴ Refuzimi kategorik nga ana e qeveria greke i përpjekjeve për një farë kompromisi, lidhej kryesisht me besimin që ajo kishte në drejtësinë e argumenteve të saj për sa i përket zbatimit të drejtë të ligjit për shpronësim të tokave bujqësore, por edhe me bindjen se argumentet e palës shqiptare nuk ishin bindës. Rezultati përfundimtar edhe i kësaj padie, tashmë zyrtare, të palës shqiptare, i dha plotësisht të drejtë qeverisë greke për qëndrimin e mbajtur.

të çështjes. Kryetar i këtij komisioni do të ishte një person neutral, i përzgjedhur nga Lidhja e Kombeve, ndërsa anëtarë të tij do të ishin dy shqiptarë dhe dy grekë, të cilët do të emëroheshin prej qeverive respektive. Zgjidhja e çështjes, gjithmonë sipas propozimit shqiptar, duhej të bëhej në bazë të marrëveshjeve që Greqia kishte nënshkruar me fuqitë e tjera, Angli, Francë dhe Itali, duke pranuar ndërkohë një ulje prej 20% të çmimit për të cilin kishin rënë dakord. Në lidhje me çamët, akuzoi sërish Greqinë për zbatim të masave kufizuese dhe të metodave të ndryshme shtypëse kundër tyre, kryesisht në sektorët jetikë të pronësisë, të përfaqësimit të tyre në këshillat komunalë dhe bashkiakë, të funksionimit të shkollave dhe të shërbimit ushtarak.

Përfaqësuesi grek Ioannis Politis iu shmang taktikës për të hedhur poshtë një nga një akuzat e palës shqiptare me hollësi, përderisa vetë këto çështje ishin diskutuar ndërkohë gjatë muajve të kaluar nga Lidhja e Kombeve, për çdo ankesë të veçantë shqiptare, dhe Këshilli i kishte gjykuar atëherë shpjegimet që kishte dhënë pala greke, si të kënaqshme. Por ai u kujdes që të theksonte edhe një herë se masa e shpronësimeve ishte e përgjithshme dhe ishte zbatuar njësoj për të gjithë qytetarët Grekë dhe se qeveria e tij nuk ishte e predispozuar t'u akordonte shqiptarëve privilegje që nuk i kishin as grekët. Përkundrazi, ai preferoi t'i tërhiqte vëmendjen Këshillit për dy çështje themelore: fillimisht vuri në dyshim bazën ligjore të padisë, e cila mbështetej në nenin 11, paragrafi 2 të Rregullores së Lidhjes së Kombeve, që kishte të bënte me çështje të cilat mund të vinin në rrezik paqen në botë ose marrëdhëniet normale midis kombeve. Sipas përfaqësuesit Politis, akuzat shqiptare kishin të bënin me çështje të dorës së dytë, të cilat autoritetet greke përpiqeshin ndërkohë që t'i trajtonin, por ato në asnjë rast nuk përbënin rrezik për marrëdhëniet mes dy vendeve. Nga ana tjetër, nisma e qeverisë shqiptare përbënte një ndërhyrje flagrante në çështjet e brendshme të Greqisë, pasi ajo tentonte të paraqitej si mbrojtëse e çamëve, duke krijuar në këtë mënyrë, një precedent të keq për mënyrën e trajtimit të minoriteteve edhe në të ardhmen¹²⁵.

¹²⁵ PRO/FO, 371/12925, 50th Session of the Council, league of Nations. Extract from Final Minutes of the 2nd Meeting Public and Private on 5th June 1928, Geneva.

Në vendimin e saj, të cilin e bëri publik vetëm pak ditë më vonë, Lidhja e Kombeve, së pari, zgjidhjen e çështjes së kompensimit të pronave që ishin shpronësuar, ia delegonte negociatave dypalëshe¹²⁶. Për sa i përket çështjes së dytë të padisë shqiptare, në lidhje me trajtimin e minoritetit shqiptar në Greqi, vendimi theksonte se ndër qëllimet kryesore të Lidhjes së Kombeve ishte evitimi i ndërhyrjes së shteteve të huaja në punët e brendshme të një vendi për çështje minoritare, si dhe kujdesi që probleme të kësaj natyre të mos shndërroheshin në vatra konflikti midis vendeve fqinje. Gjithashtu, nenit 11 të Rregullores, mund t'i referohej çdo vend, por vetëm për situata serioze, kur ekzistonte rreziku i prishjes së paqes midis kombeve. Në bazë të gjithë atyre që u përmendën më lart, Këshilli i Lidhjes së Kombeve nuk kishte për ta trajtuar më në të ardhmen çështjen që ngriti qeveria shqiptare, madje për më tepër, shumë prej temave të cilave u referohej pala shqiptare, ishin bërë edhe në të kaluarën objekt diskutimesh dhe raportesh të ngjashme¹²⁷. Siç mund ta konstatojë fare lehtë kushdo, vendimi i Lidhjes së Kombeve përbënte një përligjje të qartë të qëndrimeve greke, ashtu siç i kishte parashtruar përfaqësuesi grek Politi, dhe u dha fund një herë e mirë ankesave të njëpasnjëshme të palës shqiptare.

Lajmi për vendimin e Lidhjes së Kombeve, ashtu siç ishte e natyrshme, shkaktoi një zhgënjim të madh te pala shqiptare dhe shërbeu si shkas për komente nga më të ndryshme, bile edhe në dëm të efektivitetit të delegacionit shqiptar. Qarqe diplomatike greke vlerësonin se në kuadrin e klimës së re të krijuar, qëndrimi i Tiranës zyrtare do të bëhej më tolerant në lidhje me çështjen e pronave dhe do të pranonte më së fundi kompensimin që parashikonte ligji agrar grek¹²⁸, por ishte pothuajse e sigurt se gjendja

¹²⁶ Rasti i Greqisë nuk ishte i vetmi i cili u trajtua nga Këshilli i Lidhjes së Kombeve. Një padi të ngjashme kishin ngritur pronarë hungarezë tokash kundër shtetit rumun, i cili kishte bërë shpronësime masive. Edhe në këtë rast, Këshilli vendosi në favor të Rumanisë dhe kundër pronarëve, në një farë mase edhe për shkak të padisë shqiptare, sepse kjo organizatë ndërkombëtare nuk dëshironte të ngatërrohej në mosmarrëveshje të tilla ekonomike.

¹²⁷ Société des Nations, C. 314. 1928. VII, Geneve 8-6-1928.

¹²⁸ AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 7208, Kokotakis për Mihalakopoulos, Tiranë 15-6-1928.

me të cilën do të përballej në të ardhmen minoriteti grek i Shqipërisë do të rëndohej, kryesisht nëpërmjet imponimit të masave të tjera kufizuese në funksionimin e shkollave të tij¹²⁹. Me të vërtetë, ashtu siç do të tregonte vetë zhvillimi i ngjarjeve, parashikimet dhe vlerësimet e diplomatëve grekë do të rezultonin të vërteta.

Të paktën për momentin, u duk se dështimi në Lidhjen e Kombeve e zbuti intolerancën shqiptare, një fakt ky që i hapi rrugën afrimit me Greqinë dhe krijimit të një klime më harmonike në marrëdhëniet midis dy vendeve. Te këto zhvillime ndikoi sigurisht edhe ardhja në pushtet, në verën e vitit 1928, e Eleftherios Venizellos. Orientimi kryesor i politikës së tij të jashtme ishte normalizimi i marrëdhënieve të Greqisë me të gjithë fqinjët e saj ballkanikë dhe fuqitë europiane, kryesisht me Britaninë dhe Italinë¹³⁰. Në këtë kuadër dhe duke shfrytëzuar tërheqjen që po shfaqej tashmë tek intoleranca e palës shqiptare, Venizellos bëri një hapje të rëndësishme drejt Shqipërisë, me qëllim që t'u jepej zgjidhje çështjeve më të rëndësishme dypalëshe që kishin mbetur ende pezull. Në këtë mënyrë, Greqia ishte ndër shtetet e para, në shtator të viti 1928, që njohu shpalljen e Shqipërisë mbretëri, dhe të Ahmet Zogut, Presidentit të deriatëhershëm të Republikës, si Zog I, Mbret i Shqiptarëve. Për më tepër Venizellos, duke bërë një gjest të vullnetit të mirë, urdhëroi shpërndarjen e silogjeve vorioepirote, duke iu përgjigjur kërkesave të përhershme të palës shqiptare dhe nxitoi të emëronte ambasador në Tiranë, Leon Melanë, të cilit i dha udhëzime që të bënte gjithçka ishte e mundur në mënyrë që të lehtësonte përpjekjet për krijimin e një klime të përzemërt midis Athinës dhe Tiranës. Por ndër vendimet më të rëndësishme që mori, ishte hyrja plotësisht në fuqi, që në Tetor të 1928, të tre prej katër marrëveshjeve greko-shqiptare që ishin nënshkruar në vitin 1926 dhe që deri atëherë qëndronin pezull. Marrëveshja e katërt “Për Shërbimin Konsullor” e

¹²⁹ AYE, 1928, A/21/I, nr. pr. 7208, si dhe ASMAE, Albania 1928, 768/688, no. 1288/515, Sola për Ministero Affari Esteri, Tiranë 21-6-1928.

¹³⁰ Më shumë për politikën e jashtme të El. Venizellos në atë periudhë, shih Karamanli, *Eleftherios Venizellos dhe marrëdhëniet tona me jashtë*.

cila kishte lidhje direkte edhe me çështjen e pronave, ishte hedhur poshtë prej Parlamentit grek dhe nuk diskutohej më çështja e zbatimit të saj. Ratifikimi i marrëveshjeve u bë i mundur pasi ra dakord edhe pala shqiptare, e cila duke treguar nga ana e saj frymë bashkëpunuese, pranoi që të zbatoheshin vetëm tri marrëveshjet para diskutimit për çështjen e pronave, me shpresë se qeveria e Venizellos do t'i jepte zgjidhje edhe këtij problemi¹³¹.

Por ecuria e këtyre zhvillimeve si dhe klima e mirë që ishte krijuar midis Greqisë dhe Shqipërisë, për fat të keq nuk ishte e thënë që të vazhdonin për shumë kohë, pasi në pranverën e vitit 1929 shpërtheu një krizë e re në marrëdhëniet midis dy vendeve për shkak të çështjes kishtare¹³². Hapja që kishte tentuar qeveria Venizellos kundrejt asaj shqiptare, ngriu përkohësisht, deri në zgjidhjen e çështjes kishtare, dhe marrëdhëniet dypalëshe mbetën në vend numëro.

Ndërkohë ia vlen të theksojmë se në kuadrin e kësaj krize të re, pala shqiptare nuk ngurroi të propozojë përsëri, ashtu siç kishte bërë në vitin 1923, shkëmbimin vullnetar të grekëve të Shqipërisë dhe të çamëve të Epirit, një propozim me të cilin pala greke nuk do të binte kurrë dakord. Greqia vlerësonte se kjo masë, përveç faktit që ishte tej mase çnjerëzore, do të krijonte, pa asnjë arsye të justifikueshme, edhe probleme serioze të natyrës sociale, ekonomike dhe etnike. Për më tepër, do të krijonte një përshtypje të pakëndshme si në opinionin grek ashtu dhe në atë ndërkombëtar dhe do të përbënte njëkohësisht një tregues të qartë të pamundësisë së dy

¹³¹ Mihalopoulos, Çamët, fq. 175.

¹³² Për shpalljen e Autoqefalisë së Kishës Ortodokse Shqiptare që u bë me metoda grushti shteti dhe në përgjithësi, për ecurinë e çështjes kishtare në Shqipëri, shih Ap. Glavina, *Kisha Ortodokse Autoqefale e Shqipërisë*, Selanik 1992, si dhe Autoqefalia e Kishës Ortodokse në Shqipëri në bazë të dokumenteve të pabotuara, Janinë 1978, i të njëjtit autor. Sipas vlerësimeve të ambasadorit italian Ugo Sola, intoleranca e plotë e palës shqiptare për çështjen kishtare ishte në një masë të madhe rrjedhojë e klimës antigreke që ishte kultivuar brenda vendit pas dështimit të misionit shqiptar në Athinë dhe poshtërimit të Tiranës zyrtare prej Lidhjes së Kombeve një vit më parë. ASMAE, Albania 1930, 794/833, no. 323/140, Sola Për Ministero Affari Esteri, Tiranë 10-2-1929.